



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.35

12 mars

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.218, datë 3.2.2008

Për miratimin e strategjisë ndërsektorale të përfshirjes sociale

1559

VENDIM
Nr.218, datë 3.2.2008

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË PËRFSHIRJES SOCIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë ndërsektorale të përfshirjes sociale, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe INSTAT-i për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E PËRFSHIRJES SOCIALE
2008-2013

Shkurtime

ADRF	Albanian Disability Rights Foundation
	Community Assistance for Reconstruction, Development and
CARDS	Stabilisation
CRC	Convention on the Rights of the Child
DFID	UK Department for International Development
ECCD	Early Childhood Care and Development
EEO	Equal Employment Opportunities
EU	European Union
EUR	Euro
GDP	Gross Domestic Product
GOA	Government of Albania
GTZ	Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit
HALE	Health Life Expectancy
ISCED	International Standard Classification of Education
IDA	International Development Association
INSTAT	Albanian National Institute of Statistics
IPH	Institute of Public Health
ISS	Institute of Social Securities
KESH	Albanian Power Corporation
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau
MCYS	Ministry of Culture, Youth and Sports
MDG	Millennium Development Goal
MEUR	Million Euros
MICS	Multiple Indicator Cluster Survey
MLGD	Ministry of Local Government and Decentralisation
MOES	Ministry of Education and Science
MoLSAEO	Ministry of Labour and Social Affairs and Equal Opportunities
MOF	Ministry of Finance
MOH	Ministry of Health
MPWTT	Ministry of Public Works, Transport and Telecommunications
NAP/Incl.	National Action Plan for Social Inclusion
NCEA	National Centre for Evaluation and Assessment
NES	National Employment Service
NSSD	National Strategy for Social and Economic Development
NSDI	National Strategy for Development and Integration
NGO	Nongovernmental Organisation
OHCR	Office of the High Commissioner for Human Rights
OSCE	Organisation for Security and Cooperation in Europe
PEIR	Public Expenditure and Institutional Review

SDC	Swiss Development Cooperation
SIDA	Swedish International Development Association
SIS	<i>Social Inclusion Strategy</i>
UNECE	United Nations Economic Commission for Europe
UNHCR	United Nations High Commissioner for Refugees
UNICEF	United Nations Children's Fund
USAID	United States Agency for International Development
UNDP	United Nations Development Programme
VNICA	Vulnerability and Institutional Needs Capacity Assessment
WHO	World Health Organisation

Hyrje

Strategjia e Perfshirjes Sociale eshte nje komponent i Strategjise Kombetare per Zhvillim dhe Integrim. Ajo fokusohet ne varferine dhe perjashtimin social, rreziqe qe mbeten edhe pas rritjes ekonomike. Duke qene nje strategji ndersektoriale, ajo eshte ne perputhje te plote me strategjite sektoriale dhe ne vecanti me politikat dhe strukturat institucionale te pershkruara ne keto strategji, te cilat kane synim te ndihmojne personat vulnerabel, familjet dhe grupet ne komunitet, qe keta te mund te veprojne ne menyre te pavarur, te mund te sigurojne te ardhura dhe te kene te njejtat te drejta si dhe pjesetaret e tjere te shoqerise¹. Ajo i sherben tre qellimeve kryesore:

- Pasqyrimin te drejtimeve strategjike te qeverise, te cilat jane paraqitur me pare ne programin e qeverise (Shtator 2005), ne menyre te integruar dhe formulimit te kuadrit monitorues me anen e te cilit do te vleresohet progresi.
- Identifikimin, nepermjet nje procesi konsultimesh me grupet e interesuara jashte qeverise, dhe komunitetin e donatoreve, te politikave qe duhen permiresuar si dhe koordinimit me te mire te punes ndermjet ministrive te linjes.
- Formulimit te planit te veprimit per perfshirjen sociale, qe eshte nje kerkese standarte per pranimin ne BE.

Prezantimi i Strategjise se Perfshirjes Sociale eshte bere mbi bazen e nje Plani Veprimesh kunder Varferise dhe Perjashtimit Social te vendeve anetare te BE. Kapitulli 1 paraqet sfidat kryesore me te cilat perballohen te varferit dhe grupet e vecanta, qe ndodhen para rrezikut te perjashtimit social. Ky kapitull ndiqet nga prioritetet dhe objektivat e qeverise per te luftuar perjashtimin social (Kapitulli 2) dhe nga nje pershkrim i situates aktuale, pershkrim i strategjive dhe masave te marra ose te propozuara ne nivel kombetar per arritjen e progresit (Kapitulli 3). Indikatorete qe do te perdoren per monitorimin e progresit ne reduktimin e varferise dhe perjashtimit social jane perzgjedhur nga indikatorete me te pershtatshem te BE dhe nga indikatorete e vecante per Shqiperine, te listuar ne Kapitullin 4. Shtojcat permbajne; informacion me te gjere statistikor, pershkrimin e strukturave institucionale brenda qeverise dhe nje liste te inisiativave te vecanta qe jane vene ne zbatim nga qeveria nepermjet financimeve nga jashte.

Rritja e barabarte dhe gjithperفشirese eshte shume e rendesishme per nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social. Permiresimet e koheve te fundit ne ekonomi, kane bere qe nje numer i konsiderueshem njerezish te dalin nga varferia. Eshte e rendesishme qe proceset e zhvillimit te mos perjashtojne apo te mos lene asnje njeri pas. Deri ne vitin 2015, parashikohet qe numri i familjeve ne varferi absolute, do te reduktohet me 50 perqind dhe nuk do te kete familje qe jetojne ne varferi ekstreme. Sidoqofte, perjashtimi social nuk percaktohet vetem nga varferia. Ka grupe ne shoqeri qe jane para rrezikut te deprivimit apo barrierave te cilat nuk i lejojne te marin pjese plotesisht ne shoqeri, dhe per kete arsye qe politikat te jene te efektshme, duhet te targetohen ndaj nevojave te tyre. Natyra multidimensionale e varferise dhe perjashtimit social kerkon veprim ne shume fronte. Megjithese kjo strategji eshte ne nivel kombetar, pushteti lokal, me fillimin e decentralizimit, do te luaje rol ne permiresimin e aksesit ne sherbime dhe ne sigurimin e integritet te grupeve ne minoritet. Per kete nevojitet partneritet me OJF-te dhe donatorete per zhvillimin e politikave dhe monitorim, per financime dhe ofrimin e sherbimeve. Lufta kunder varferise dhe perjashtimit duhet te jete pjese e te gjitha politikave te qeverise dhe te pranohet nga shoqeria.

¹ Kjo strategji e ka burimin nga strategjite e Mbrojtjes Sociale, Punesimit, Arsimit, Shendetsise, Transportit, Fumizmit me Uje, Planifikimit Urban dhe Drejtesise, te cilat jane miratuar ose jane ne process formulimi. Kjo strategji duhet pare ne lidhje me strategjite ndersektoriale te Zhvillimit Urban, kunder Krimin te Organizuar, Terrorizmit dhe Trafikimit, Informacionit dhe Teknologjise se Komunikacionit dhe Decentralizimit.

Kapitulli 1 Tendencat kryesore

Zhvillimi Ekonomik

Shqipëria mbetet një nga vendet me të ardhura me të ulta për frymë në Europë, €2150 në vitin 2006. Por, rritja kumulative e të ardhurave që nga viti 1990, ka qenë nga më të lartat e ekonomive në tranzicion. Të ardhurat reale e kanë kaluar nivelin para tranzicionit, megjithë faktin që vendi kaloi një periudhë të vështirë mungese të rendit në vitin 1997.

Si në të gjitha vendet në tranzicion, mekanizmi kryesor i rritjes ka qenë rishpërndarja e burimeve në aktivitete më produktive, nëpërmjet reformave të tilla si liberalizimi i çmimeve dhe tregëtisë dhe privatizimi i pronave dhe ndërmarrjeve. Kjo u arrit nëpërmjet një kuadri të stabilizuar makroekonomik: deficit i buxhetor ka rënë nga 7.5 përqind e GDP në vitin 2000 në 3.1 përqind të GDP në vitin 2006, ndërsa inflacioni ka qenë nën 3 përqind në këto vitet e fundit. Sidoqoftë, norma e mbledhjes së të ardhurave publike (25.2 përqind e GDP në vitin 2006) mbetet më e ulët se mesatarja e vendeve të rajonit (për shembull 35.8 përqind në Maqedoni, 40.6 përqind në Bullgari, dhe 44.9 përqind në Kroaci) sipas raportit të fundit të FMN. Sidoqoftë, të dhënat e fundit nga Ministria e Financës tregojnë se të ardhurat totale janë rritur 13.6 përqind në krahasim me vitin e kaluar. Përqindja e lartë e dergesave nga jashtë ka stimuluar kërkesën për shërbime dhe ndërtim: në vitin 2005 dergesat arritën €802 milion ose 11.6 përqind të GDP.

Gjate dy viteve të fundit, norma vjetore e rritjes ka një mesatare prej pesë përqind. Por, në të njëjtën kohë, studimet tregojnë se norma e rritjes së produktivitetit ka qenë në rënie². Ndonëse është e vështirë që kjo tendencë t'i atribuohet ndonjë faktori të vecantë, është theksuar se problemet institucionale që lidhen me korrupsionin dhe shtetin ligjor mund të përbejnë një pengesë për rritjen e produktivitetit dhe për këtë kërkojnë reforma strukturore. Pavaresisht nga përmirësimet, gjendja e energjisë, transportit dhe infrastrukturës ujore mbetet një shqetësim i madh.

Zhvillime Demografike

Popullsia e Shqipërisë, e regjistruar nga Repoba 2001, është 3.1 milion. Por duhet marrë në konsideratë edhe popullsia e emigruar gjatë 15 viteve të fundit dhe që vlerësohet të jetë rreth 800 mijë. Popullsia e Shqipërisë është më e reja në Europë, me një popullsi nën 15 vjeç prej 29.5 përqind, ndërsa përqindja e popullsisë mbi moshën 65 vjeç ishte 7.4 përqind (Repoba 2001) (në BE15 mesatarja është 16.6). Në pesëmbëdhjetë vitet e ardhshme, kjo shpërndarje e popullsisë do të ndryshojë gradualisht. Në varesi të pjellorisë, përqindja e popullsisë nën moshën 15 vjeç pritet të jetë 19-22. Në varesi të migracionit, përqindja e popullsisë mbi moshën 65 vjeç pritet të rritet në 12-13 përqind³. Edhe në këtë rast, popullsia e Shqipërisë do të jetë më e reja.

Periudha e tranzicionit është karakterizuar nga ritme të larta migracioni. Në pari, migracioni i brendshëm nga zonat rurale në ato urbane, dhe sidomos autostrada Tiranë-Durrës, solli rritjen e popullsisë urbane nga 35.5 përqind në vitin 1991 në 42 përqind në vitin 2001. Përqendrimi në zonat urbane mund të jetë shumë i madh, nëse marrim parasysh dhe vendbanimet e të ardhurve në periferi të qyteteve, të cilat konsiderohen rurale nga pikepamja administrative. Ndërtimet e shumta pa leje në periferi të qyteteve, nënkuptojnë që banorëve u mungon energjia, uji, kanalizimet, rrugët dhe shërbime të tjera baze të lidhura

² Për shembull, Shqipëria: Çështje të vecanta, Raporti i IMF 06/285, Qershor 2006

³ Parashikimet e popullsisë për Shqipërinë 2001-2021, REPOBA 2001, INSTAT, 2004

me infrastrukturen. Se dyti, emigracioni jashte vendit, sidomos ne Greqi dhe Itali, ishte aq i madh sa pati nje renie te banoreve nga viti 1991 ne vitin 2001. Emigracioni jashte vendit ka qene i perhershem dhe i perkohshem.

Varferia dhe Perjashtimi Social

Norma e varferise

Norma e varferise ne Shqiperi eshte nga me te lartat ne Europe. Vezhgimi i Nivelit te Jeteses (LSMS) ben te mundur monitorimin e tendencave dhe karakteristikave te varferise per periudhen nga viti 2002 ne vitin 2005.⁴ LSMS gjithashtu eshte ne gjendje te mate aspektet e ndryshme te perjashtimit social ne kuptimin qe "lloje te ndryshme deprivimi dhe barrierash, bashke apo vec, parandalojne pjesemarrjen e plote ne fusha te tilla si punesimi, arsimi, shendetsia, mjedisi, strehimi, kultura, aksesit tek te drejtat apo mbeshtetja familjare, si dhe formimi professional dhe mundesia per pune."⁵

Si rezultat i ritmeve te larta te rritjes keto vitet e fundit, ka patur nje reduktim masiv te varferise. Varferia absolute, ku konsumi mujor per fryme ishte nen 4891 lek me cmimet e vitit 2002, ra nga 25.4 perqind ne vitin 2002 ne 18.5 perqind ne vitin 2005. Varferia absolute ekstreme, ku konsumi mujor per fryme ishte nen 3047 lek me cmimet e vitit 2002, ku perfshihet edhe popullsia qe mezi siguron nevojat baze per ushqim, pati nje renie nga 4.7 perqind ne 3.5 perqind.

Normat dhe tendencat e varferise nuk jane te njejta ne te gjitha vendin. Por per shkak te kufizimeve ne zgjedhje, LSMS mund te jape vleresime te besueshme per zonat urbane dhe rurale dhe per kater rajone te medha te vendit; Tirana, Bregdeti, Pjesa Qendrore dhe Malore.⁶

Tabela 1 Normat e varferise per Shqiperine ne vitet 2002 dhe 2005 ne te gjitha rajonin dhe sipas zonave urbane/rurale (perqind)

Rajoni	Varferia absolute, 2002	Varferia absolute, 2005	Varferia ekstreme, 2002	Varferia ekstreme, 2005
Bregdeti	20.6	16.2	3.6	2.2
Qendror	25.6	21.2	4.6	5.2
Malor	44.5	25.6	10.8	3.2
Tirana	17.8	8.1	2.3	1.0
Zona te tjera urbane	20.1	12.4	4.8	2.7
Rurale	29.6	24.2	5.2	4.5
Totali	25.4	18.5	4.7	3.5

Burimi: LSMS 2002 dhe LSMS 2005

⁴ Treguesit e Varferise bazohen ne vleresimet e konsumit dhe jo ne vleresimin e te ardhurave sepse konsiderohet qe informacioni per te ardhurat nuk eshte shume i sakte.

⁵ COM (2000) 79 final: komunikim nga Komisioni: *Te ndertojme nje Europe Gjithperفشیره*

⁶ Zona *bregdetare* perfshin qarqet e Lezhës, Kurbinit, Kavajës, Mallakastres, Lushnjes, Delvines, Sarandes, Durrësit, Fierit, dhe Vlores), rajoni *qendror* perfshin qarqet e Kucoves, Skraparit, Krujes, Peqinit, Gjirokastrës, Permetit, Tepelenes, Devollit, Kolonjes, Pogradecit, Mirdites, Pukes, Malesise se Madhe, Shkodres, Elbasanit, Beratit, Korces, Matit, dhe Tiranes-*fshat*), dhe zona *malore* perfshin qarqet e Kukësit, Hasit, Tropojës, Bulqizës, Dibres, Gramshit, dhe Librazhdit.

Analiza e te dhenave tregon se reduktimi i varferise mund te kishte qene me i shpejte nese nuk do te ishte rritur pabarazia dhe per shkak se disa te varfer nuk perfituan njesisht nga rritja ekonomike. Kjo u vu re sidomos ne zonat bregdetare dhe qendrore. Ndermjet standarteve per matjen e pabarazise, perqindja e konsumit total nga 20 perqind e popullsisë me te varfer, pati nje rënie nga 12.7 ne 8.2 perqind nga viti 2002 ne vitin 2005.⁷

Kufiri i varferise absolute percaktohet ne lidhje me shportën e artikujve ushqimore dhe jo ushqimore dhe ben te mundur krahasimin ne kohe dhe ndermjet grupeve te popullsisë. Kufiri i varferise relative, qe eshte masa e preferuar ne Bashkimin Europian, pasqyron shkallen e privimit ne relacion me te ardhurat e pjeses tjeter te popullsisë. Masa me e zakonshme eshte e ashtuquajtura "norma e te rrezikuarve nga varferia", qe shpreh pjesen e personave qe jetojne ne familje, me nje konsum me te vogel se 60 perqind e medianit kombetar. Keto masa jane shume te ndryshme ndaj ndryshimeve te pabarazise, qe reflektohet dhe ne tabelen e meposhtme, e cila sugjeron qe norma e varferise relative eshte rritur mesatarisht ndermjet vitit 2002 - 2005.

Tabela 2 Krahasimi i normave te varferise relative nga 2002 ne 2005 sipas zonave

Rajoni	Varferia relative, 2002	Varferia relative, 2005
Bregdeti	11.3	14.1
Qendrore	14.3	20.0
Malore	23.9	20.4
Tirana	9.1	7.5
Totali	13.9	16.6

Burimi: LSMS 2002 dhe LSMS 2005

Ne kontekstin e Shqiperise, te dy llojet e indikatorëve jane te rendesishem sepse na japin nje pamje me te gjere te ndryshimeve te mireqenjes se popullsisë.

Karakteristikat e te Varferve

Tabela e meposhtme tregon se varferia eshte e shoqeruar me karakteristika specifike demografike. Per shembull, familjet e varfera, kane tendence te kene shume anetare, me shume femije, dhe ka me shume mundesi te kene te pjesetare te familjes te papune. Per me teper, njerezit e varfer vuajne nga aksesit i pakët ne shërbimet baze, te tilla si shkollat, qendrat shëndetsore, telefonat, uji dhe higjiena.

⁷ Koeficienti Gini, qe mat ndryshimin e shpërndarjeve aktuale dhe shpërndarjeve te barabarta, eshte rritur disi nga 0.28 ne 0.29. Kjo eshte e krahasueshme me mesataren e BE15 (0.31) por duhet marre parasysh se te dhenat per Shqiperine I referohen pabarazise se konsumit, qe ka tendence te shpërndahet me barabar se te ardhurat.

Tabela 3 Karakteristikat e te varferve

	2002			2005		
	Jo te varfer	Te varfer	Shume te varfer	Jo te varfer	Te varfer	Shume te varfer
Madhesi mesatare e famjes	4.0	5.7		4.0	5.5	
Familje me gra kryefamiljare (%)	13.1	9.3		11.7	8.1	
Mosha 60 dhe lart (%)	19.7	10.2		14.7	9.8	
Numri i anetareve nen 15 vjec	1.0	2.1		0.9	1.9	
Norma e varesise ¹	0.77	1.12		0.7	1	
Te papune (%) ²	5.0	8.7	13.4	3.4	4.8	
Punetore te dekurajuar, sezonale dhe te pushuar (%)	3.6	5.3	6.4	3.4	4.2	
Vitet e arsimit te kryefamiljarit	7.9	6.2		9.8	8.0	
Rregjistrimet neto ne arsimin nentevjecar (%) ³	89.3	86.4	88.6	92.3	82.8	
Rregjistrimet neto ne arsimin e mesem (%)	46.7	19.4	19.8	53	23.9	
Distanca nga qendra shendetsores: nje ore apo me shume (%)	7.4	14.7		5.6	12.7	
Popullimi: me shume se 3 persona ne nje dhome (%)	20.3	48.6		18.7	44.9	
Aksesi tek telefonia fikse (%)	25.2	7.1		27.2	5.8	
Aksesi tek telefonia celulare (%)	46.9	15.9		83.9	64	
Uje i pishem Brenda baneses (%)	55.7	32.7		58	31.5	
Tualet jashte banese dhe pa tubacione (%)	68.0	41.4		73.9	45.8	
Energji: me shume se 12 ore ne dite pa sherbim ne 24 ore (%)	12.5	16.1		1.5	3	

Shenime: (1) Perqindja e varesise = (numri i femijeve 0-14) + (numri i te moshuarve 60 e lart) / (numrin e anetareve te familjes te moshes 15-59). (2) te papunet jane vetem punetoret e moshes 15 vjec e lart. (3) Norma neto e rregjistrimeve eshte numri i femijeve te rregjistruar si perqindje e totalit te femijeve te moshes shkollore.

Kapitulli 2: Vizioni, Prioritetet dhe Objektivat

Me shume prosperitet shoqeruar me nje zhvillim te qendrueshem, do te nxjerre njerezit nga varferia. Zhvillimi shoqeror do te beje te mundur pjesemarrjen e te gjithëve ne shoqeri. Cdo femije do te jetoje nje jete me te mire. Te gjithë njerezit e afte per pune do te kene mundesi te punojne dhe ata qe nuk mund te punojne, do te kene te ardhura te mjaftueshme per nje jete dinjitoze. Asnje nuk do te perjashtohet apo nuk do te mbetet mbrapa.

Per arritjen e ketij vizioni, qeveria i ka dhene rendesi te vecante:

- Sigurimit te mbrojtjes se tregut formal te punes
- Rritjes se pjesemarrjes se grave ne tregun e punes
- Kapercimit te disavantazheve ne arsim dhe formimin profesional ne vecanti rregjistrimit ne arsimin e mesem
- Modernizimit te asistences sociale
- Zbutjes se varferise se femijeve
- Permiresimit te aksesit tek sherbimet per grupet vulnerabel
- Kapercimit te barrierave ne pjesemarrje, per Romet PAK dhe te moshuarit
- Reduktimin e dhunes ne familje

Per perfshirjen sociale jane percaktuar objektivat e meposhtme:

Niveli i Varferise

- Deri ne vitin 2015 varferia absolute do reduktohet ne 12.2 perqind dhe nuk do te kete familje qe do jetoje ne varferi ekstreme.

Pjesemarrja e Grave ne Tregun e Punës

- Perqindja e grave ne pune te paguara ne sektorin privat jo bujqesor deri ne vitin 2009 do te jete 45% .

Formalizimi i Tregut te Punës

- Deri ne vitin 2009, 75 perqind e te papuneve (perfshi ata qe nuk jane aktive) do te vleresohen dhe 40 perqind nga ky kontingjent do t'u ofrohet nje forme formimi profesional

Kapercimi i Disavantazheve ne Arsim dhe Trainim

- Deri ne vitin 2010 financimi i arsimit do te jete 5 perqind e GDP.
- Deri ne vitin 2015 arsimimi jetik i te rinjve parashikohet te jete mesatarisht 13 vite
- Deri ne vitin 2009 , 40 perqind e popullsise nga 15-24 vjeç qe ka përfunduar arsimin e detyruar 8-vjeçar , do te kene nivelin me te larte te arsimit ISCED 0, 1, 2.

Modernizimi i Asistences Sociale

- Deri në vitin 2013, masa e ndihmës ekonomike për familje (9000 leke) do të tentojë aritjen e treguesit të nivelit të varfërisë, brenda një kufiri tavan që nuk e kalon nivelin e pensionit minimal në shkallë vendi.
- Ne 2013 synohet qe nr i familjeve qe perfitojne ndihme ekonomike te jete 70000.

- **Permiresimi i vleresimit te perfituesve per familjet aplikante**
- **Kushtezimi i perfituesve te ndihmes ekonomike me pune ne komunitet**

Perkujdesi Social

- Deri ne vitin 2013 do te perfundoje procesi i deinstitutionalizimit te sherbimit te femijeve.
- Deri ne 2009 do te krijohen sherbime te reja te tipit ne familje.

Shendetsia

- Deri ne vitin 2009, shkalla e vdekshmerise amtare per 100 mije lindje te gjalla do te jete 12.
- Deri ne vitin 2009 , shkalla e vdekshmerise foshnjore per 1000 lindje te gjalla do te jete 11.

Strehimi

- Rritja e siperfaqes se banimit per person
- Banesat sociale me qera do te perbejne te pakten 1% te fondit te pergjithshem te banesave
- Banesat me kosto te ulet do te perbejne rreth 5% te fondit te pergjithshem te banesave nepermjet skemave te partneritetit
- Rehabilitimi deri ne masen 50% i vendbanimeve te komunitetit rom

Asistenca Ligjore

- Institutionalizimi i asistences ligjore falas per grupet ne nevoje.

Furnizimi me Uje

- Deri ne vitin 2009, 94 perqind e popullsise urbane do te kete akses ne ujin e pishem.
- Deri ne vitin 2009, 55 perqind e popullsise ne zonat rurale do te jete e mbuluar me uje te pijshem.
- Deri ne vitin 2009 , 47% e popullsisë rurale do te jete e lidhur me rrjetin e kanalizimeve
- 12 orë do të jetë mesatarja e furnizimit me ujë e popullatës

Transporti

- Deri ne vitin 2009 do te rehabilitohen dhe asfaltohen 4000 kilometra ruge rurale.

Telekomunikacioni

- Deri ne vitin 2009 norma e penetrimit te linjave fikse per familje do te rritet ne masen 90 perqind.

Femijet e Rrezikuar

- Deri ne vitin 2015 te gjithë femijet e moshes 5-6 vjecare do te kene akses ne arsimin parashkollor.

- Vdekshmeria e femijeve nen pese vjec do te reduktohet ne 10 vdekje per 1,000 lindje deri ne vitin 2015.

Integrimi i Romeve

- Rritja e perqindjes se punesimit te grave rome.
- Rritja e shkalles se arsimimit te femijeve te komuniteteti rom.
- Ofrimi i trainimit profesional pa pagese.

Personat me Aftesi te Kufizuar

- Pagesa baze e PAK do te indeksohet cdo vit me rritjen e pages minimale ne shkalle vendi.
- Kalimi i te gjitha institucioneve rezidenciale te PAK ne varesi te qeverisjes vendore deri ne fund te vitit 2008. Ngritja dhe venia ne fuksionin e 9 sherbimeve komunitare ditore per PAK ne njesi te ndryshme te qeverisjes vendore.

Te moshuarit

- Deri ne vitin 2009, do te kete dyfishim te pensioneve dhe nuk do te kete pensione nen kufirin kombetar te varferise
- Kalimi i te gjitha institucioneve rezidenciale te te moshuarve ne varesi te qeverisjes vendore deri ne fund te 2008.

Reduktimi i dhunes ne familje

- Rritja e ndergjegjesimit ndaj dukurise se dhunes , mbrojtje ligjore dhe administrative si dhe mbeshtetje per individe te prekur nga dhuna ne familje dhe dhunuesit.

Kapitulli 3

Sfida te rendesishme dhe Politikat e Zbatuara

Ky kapitull pershkruan situaten e bazuar ne informacionin e seciles fushe prioritare: tregu i punes, asistenca sociale; aksesit tek sherbimet dhe fusha te vecanta ku perfshihen femijet; romet; personat me aftesi te kufizuara; barazia gjinore dhe dhuna ne familje. Ne vijimesi, analiza e situates eshte pershkrim i politikave te qeverise qe kane per qellim reduktimin e varferise dhe pakesimin e rezikut te perjashtimit social.⁸

Permiresimi i te ardhurave nepermjet punesimit dhe arsimimit

Rritja e punesimit tashme, eshte nje detyre prioritare e politikës social-ekonomike te Qeverise, si dhe e te gjithe shoqerise. Kjo do te ndikojë ne menyre te drejtperdrejte ne reduktimin e varferise dhe ne perfshirjen e te gjithe qytetareve ne jeten sociale, ekonomike dhe politike te vendit. Politikat e lehtesimit te pjesemarrjes ne punesim te grupeve te vecanta, zgjerimi i tregut te punes dhe fuqizimi i mesimit gjate gjithë jetes do te marrin rendesi te vecante ne vitet ne vazhdim. Ne lidhje me perfshirjen sociale ne fushen e punesimit jane targetuar prioritetet ne vazhdim.

Rritja e Pjesemarrjes se Grave ne Tregun e Punes

Situata

Sipas Rregjistrimit te Popullsise, krahu i punes ne Shqiperi⁹ ka rënë 15 perqind nga viti 1989 ne vitin 2001. Si rrjedhim i emigracionit jashte vendit, krahu i punes numeron 5 perqind me pak burra, dhe 25 perqind me pak gra. Ka te dhena qe grate nuk jane te inkurajuara dhe per rrjedhoje jane me pak aktive ne kerkimin e punes. Ne mungese te nje analize per krahun e punes, INSTAT perdor dy burime te tjera per monitorimin e tendencave te tregut te punes, te dhena administrative dhe te dhena nga vezhgimet e njesise familjare. Norma e pjesemarrjes ne krahun e punes te burrave te moshes 15-59 vjec ne vitin 2005, vleresohet ndermjet 68.5 perqind (sipas te dhenave administrative) dhe 73 perqind (sipas LSMS) te familjeve. Po keshtu, norma e pjesemarrjes ne krahun e punes per grate e moshes 15-54 vjec ne vitin 2005 vleresohet respektivisht nga 47 perqind (te dhena administrative) ne 50 perqind (LSMS).

Gjashtedhete e shtate perqind e grave te punesuara ne rang kombetar, punojne ne zonat rurale dhe nga keto 87 perqind jane te vete-punesuara apo te papaguara. Veprimtaria e krahut te punes ne zonat rurale eshte shume e lidhur me fermen e familjes.¹⁰ Punesimi i grave ne zonat urbane ka pesuar ulje per shkak te: mbylljes se fabrikave, rritjes se veprimtarive te burrave, te tilla si tregtia dhe ndertimi; migrimi i brendshem ne zonat urbane, ne te cilin grate, ne kushtet aktuale ekonomike, hasin me shume probleme per te hyre ne tregun e punes.

⁸ Shtojca 1 jep nje pamje te plote statistikore te situates dhe Shtojca mbi Veprimtarite Specifike paraqet projektet ne secilen prej fushave prioritare.

⁹ Personat e moshes 15 vjec dhe lart te cilat ose jane te punesuar ose te papunesuar por qe kerkojne pune ne menyre aktive

¹⁰ Vleresimi i Tregut te Punes ne Shqiperi, Banka Boterore, 2006

Perqindja e papunesise e matur ne baze te te papuneve te regjistruar ne zyrtat lokale te punes ishte 13.8 perqind ne vitin 2006 dhe ka vazhduar te jete ne renie , ashtu siç pritet edhe nga ritja ekonomike e viteve ne vazhdim. Perqindja e papunesise tek grate e matur nga zyrtat lokale te punes ishte 5 perqind me e larte sesa perqindja e papunesise se burrave. Sipas LSMS, e cila ben dallimin ndermjet puneckerkuesve aktive dhe te dekurajuar, nje perqindje me e madhe njerezish do te donin te punonin por keta nuk jane ne kerkim aktiv per pune.

Mendimi i pergjithshem eshte qe – pavaresisht nga perqindja e larte dhe e qendrueshme e rritjes – norma e krijimit te vendeve te punes ka qene modeste. Vleresimi i Tregut te Punes arrin ne perfundimin se barriera me e madhe ne krijimin e vendeve te punes eshte mjedisi i pafavorshem per biznesin. Shkeljet e kontratave, praktikat jo konkurruese, korrupsioni, rregullat doganore dhe tregtare, normat tatimore dhe energjia, citohen te gjitha si probleme te rendesishme per Shqiperine.¹¹

Megjithese Kodi i Punes i vitit 1995 dhe Ligji per Barazine Gjinore ne Shoqeri ligjerojne trajtimin e barabarte per burrat dhe grate, mesatarisht fitimet e grave jane me te ulta se ato te burrave, ashtu siç eshte edhe perqindja e pjesemarrjes. Te dhenat e INSTAT tregojne se mesatarja e rroges mujore te grave eshte me e ulet se ajo e burrave ne te gjithe sektoret e ekonomise. Diferenca e pagave midis burrave dhe grave mund te jete faktor pengues ne pjesemarrjen e grave ne tregun e punes. Burrat paguhen mesatarisht 35 perqind me shume se grate me te njejtat karakteristika te tilla si niveli i arsimimit, eksperienca ne pune, sektori i njejte i punesimit etj.

Detyra e Politikës: Inkurajimi i pjesemarrjes se grave ne tregun e punes formal .

Masat

Nje nga shtyllat kryesore te Programit te Qeverise eshte punesimi i çdo shqiptari qe eshte ne gjendje dhe ka deshire te punoje , nepermjet harmonizimit te kerkeses dhe ofertes per pune. Qellimi final eshte reduktimi i nivelit te papunesise ne nivelin e Shteteve te BE. Me mbeshtetjen e komunitetit nderkombetar, qeveria angazhohet ne nje seri strategjish te cilat do te permiresojne dukshem klimen e biznesit dhe do te zgjerojne tregun formal te punes. Kjo do te krijojte hapesire per adresimin e çeshtjeve te tjera.

Politikat e veçanta te perfshira ne Strategjine Sektoriale te Punesimit qe reflektojne angazhimin per barazi dhe mosdiskriminim ne favor te grupeve ne nevoje, jane:

- Profesionalizimi i sherbimeve te punesimit dhe aplikimi i standarteve nderkombetare ne krijimin e aftesive per pune;
- Asistence e vecante per trainim dhe punesim per grupet ne nevoje;
- Reduktimi i tarifave te kurseve per grupet specifike qe kane qene te perjashtuar nga tregu i punes ne momentin qe regjistrohen si te papune. Keto perfshijne: PAK, te rinj ne nevoje, viktimat te trafikimit, ish te burgosur dhe grate Rome dhe/ose Egjiptiane.¹²
- Programe per nxitjen e punesimit te targetuara per permiresimin e punesimit per grate; sidomos punesimi i grave nga komuniteti Rom, gra mbi 35 vjec, gra te divorcuara me probleme sociale dhe gra me paaftesi. Ky program vepron nepermjet a) subvencioneve direkte per punedhenesit b) trainimit gjate punes dhe c) reduktimit te tarifave te programeve te formimit profesional.¹³

¹¹ Vleresimi i Tregut te Punes ne Shqiperi, Banka Boterore, 2006

¹² DCM- Sistemi i Tarifave te Formimit Profesional, 4.04.2006

¹³ DCM- Programet per Nxitjen e Punesimit per Grate e Papuna, 18.09.2003. I perfshire ne Strategjine Sektoriale te Punesimit dhe vene ne zbatim nga SHKP.

Synimi

- Deri ne vitin 2009, perqindja e grave ne pune te paguar ne sektorin privat jo bujqesor do te jete 45 %.

Formalizimi i Tregut te Punes

Situata

Informaliteti i larte ne ekonomi me shume para cash, dhe nje kulture e ulet pershtatjeje, ka rezultuar ne nje baze te ardhurash te ulta. Per te mbeshtetur planin e saj te zhvillimit, ku perfshihet dhe sigurimi i nje rrjeti sigurimesh per te varferit, qeveria ka nevoje per nje rritje te qendrueshme te te ardhurave. Ne transparencen dhe zbatimin e ligjit te taksave ka shume mangesi te medha dhe ka shume raste te paraportuara nga punonjesit per shkak te Taksës mbi Te Ardhurat Personale dhe mospageses se Kontributit per Sigurimet Shoqerore.

Ne sektorin jo bujqesor, 55 perqind jane te punesuar ne menyre informale. Ketu perfshihen 28 perqind qe jane te vete-punesuar ose te papaguar dhe 27 perqind e krahut te punes e cila nuk eshte e regjistruar ku nje numer i madhe i tyre punojne ne sektorin e ndertimit (LSMS 2005). Pergjithesisht, ato vijne nga familje te varfra dhe nuk kane arsim te mjaftueshem. Punetoret e sektorit informal punojne me ore te gjata per pagese te ulet dhe nuk ju paguhen sigurime shoqerore dhe si rrjedhim nuk kane te drejte te ankohen sipas kodit te punes. Shoqerite qe veprojne ne tregun informal nuk ka gjasa te investojne per kualifikimin e punetoreve te tyre. Gjate dy viteve te fundit vihet re nje kalim i punetoreve te sektorit informal ne sektorin formal.

Detyra e politikës: Zgjerimi i tregut te punes dhe ne te njejten kohe pakesimi i tregut informal te punes.

Masat

Bashkepunimi me i gjere ndermjet Sherbimit Kombetar te Punesimit, Inspektoriatit Shteteror te Punes, zyrave te tatimeve dhe doganave, do te rriste kontrollin e tregut te punes. INSTAT ka krijuar nje regjister per ndermarrjet e bashkuara te cilat do te zgjerohen me ndermarrje te tjera. Sistemi bankar do te fuqizohet per te kontrolluar levizjen e parase me synim monitorimin e tregut informal te punes.

Nje nga prioritetet e Strategjise se Sektorit te Finances 2008 -2013 eshte shpermdarja e taksave ne menyre me te barabarte nepermjet formulimit te nje politike dhe masave administrative qe do te reduktojne mungesen e motivimit per punesimin formal, duke arritur nje nivel me te larte pershtatshmerie. Strategjia e Finances perfshin edhe formulimin e taksave miks te cilat do te mbeshtesin me mire politikat per barazi, dhe zhvillimin e ekonomise dhe te biznesit, nepermjet ngritjes se kapacitetit te administrates dhe arrijten e nje niveli te pranueshem pershtatshmerie. Per periudhen afat-shkurter dhe afat-mesme, reforma e politikave tatimore me synimin e thjeshtezimit dhe reduktimit te normave tatimore do te behet gradualisht, per te bere te mundur qe fitimet nga te ardhurat te jene te qendrueshme. Theksi do te vihet ne reduktimin e politikave tatimore mbi punen, kryesisht nepermjet shkurtimeve te taksave mbi sigurimet shoqerore, qe kane qene nder me te lartat ne rajon. Duke filluar nga mesi i vitit 2006, u rishikua ne ulje kontributi i sigurimeve shoqerore dhe shendetesore per pjesen e punedhenesit nga 29% ne 20%, çka perben nje ulje te ndjeshme te reduktimit te taksave mbi punen. Nje politike e tille synon ne rritjen progresive te numrit te deklaruar te punonjesve. Per periudhen afat-shkurter dhe afat-mesme, jane parashikuar reduktime paralele per taksen mbi fitimin dhe taksen mbi te ardhurat personale. Reduktimi i taksës mbi fitimin dhe i normës tatimore per bizneset, do te ule motivin per te mos raportuar dhe per tu regjistruar si biznes i vogel.

Cilesia e krahut te punes do te rritet nepermjet kualifikimit ne profesionet me te kerkuara nga tregu i punes. Do te vendosen standarte per kualifikimet profesionale te cilat do te njihen ne rang nderkombetar.

Nga Vezhgimi i Krahut te Punes, i kryer nga INSTAT ne vitin 2007, do te ofrohet informacion i vlefshem per te kuptuar tregun informal te punes dhe per zhvillimin e politikave per pakesimin e tregut te punes informal.

Synimi

- Deri ne vitin 2009, do te jene vleresuar 75 perqind e te papuneve (ku perfshihen ata qe nuk jane aktive) dhe 40 perqind prej tyre do t'ju ofrohen forma kualifikimi.

Kapercimi i Disavantazheve ne Arsim dhe Formim Profesional- Rritja e regjistrimeve ne Arsimin e Mesem

Situata

Arsimi eshte mjaft i rendesishem per zhvillimin e krahut te punes te kualifikuar qe do te mbeshtese rritjen ekonomike. Sidoqofte, shpenzimi publik per arsimin kishte rene nga 4.2 perqind e GDP ne vitin 1996 ne 2.8 perqind ne vitin 2004. Ne vitet ne vazhdim shpenzimi publik per arsimin eshte rritur me nje shifer prej 3.4 perqind e GDP ne vitin 2006. Financimi i Arsimit te mesem ka qene i pamjaftueshem dhe per pasojë ka penguar zhvillimin e tij e sidomos atij profesional. Nje situatë e tille do te thote, klasa me me shume nxenes, shkolla me dy turne dhe masa te tjera efikase ne arsimin e mesem ne krahasim me arsimin nentevjecar.¹⁴

Nderkohe qe regjistrimi i pergjithshem ne arsimin nentevjecar eshte prane realizimit, perqindja e regjistrimeve ne arsimin e mesem ne vitin 2005 ishte vetem 59 perqind. Kjo perben afersisht dy te tretat e normave te 15 shteteve te BE dhe te 8 shteteve anetare te BE. Aksesit eshte i pabarabarte. Perqindja e regjistrimeve per arsimin e mesem ndermjet nxenesve nga 20 perqind e familjeve me te varfera eshte 30 perqind, ne krahasim me 79 perqind nga 20 perqind e familjeve me te pasura (LSMS 2005). Diferenca ne regjistrime zmadhohet shume per zonat rurale. Ne Shqiperi, nje femije nga 20 perqindshi i familjeve me te varfera mund te marre 10.2 vite arsimim gjate jetes se tij/saj, ne krahasim me nje femije nga 20 perqindshi i familjeve me te pasura qe merr 16.5 vite arsimim. Shqiptaret e moshes nga 25-64 vjec kane 9.6 vite arsimim ne krahasim me mesataren e OECD qe eshte 14 vjet.¹⁵ Edhe grupet e vecanta jane ne disavantazh ne lidhje me aksesin ne arsim, ku perfshihen Romet dhe femijet me aftesi te kufizuara (shih me poshte).

Nga nje vleresim i bere nga Qendra Kombetare e Vleresimit (NCAE) jane identifikuar ndryshime te rendesishme ne rezultatet e te mesuarit sipas rajoneve, dhe statusit social-ekonomik. Nxenesit e klases se katert qe vijne nga 25 perqind e familjeve me te pasura kane patur rezultate me te mira ne vleresimin e leximit, matematikes dhe gjuhes shqipe sesa nxenesit nga familjet qe jane ne 25 perqindshin e fundit. Nxenesit qe jetojne ne zona urbane dhe ne klasa normale mesatarisht kane rezultate me te mira sesa nxenesit ne zonat rurale.

Detyra e politikës : Parandalimi i largimit te hershem nga arsimi , nepermjet sigurimit te aksesit për të gjithë femijet e sidomos për grupet e marginalizuara dhe permiresimit te cilesise se arsimit. Fuqizimi i arsimit profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

¹⁴ World Bank PEIR, 2006

¹⁵ World Bank PEIR, 2006

Masat

Vizioni i qeverise lidhet me arsimin e vazhdueshem duke filluar nga mosha parashkollore dhe duke vazhduar gjate gjithë jetes – *per te ofruar arsim cilesor dhe masiv per te gjithë*. Fondet publike per arsimin, perfshi dhe arsimin e larte parashikohen te arrijne ne nivelin 5 perqind te GDP. Objektivi i sistemit arsimor do te jete zhvillimi i kapaciteteve dhe aftesive individuale per te fituar njohuri dhe per t'i perdorur ato.

Politika qe nxitin barazine perfshijne; arsimin parashkollor falas, arsimin baze ku perfshihen edhe librat shkollore, arsimin e mesem, transport falas dhe bursa akomodimi per femijet qe ndjekin shkolla te cilat jane larg shtepive te tyre (shpesh ne zona rurale te varfëra) dhe incentiva te vecanta per terheqjen e mesuesve per te punuar ne zonat e largëta dhe te veshtira.

Reformimi i sistemit të financimit të shërbimit arsimor, duke u bazuar në principin financime/nxënës ku do të përfshihen edhe faktorë që lidhen me disnivelet e zhvillimit ekonomik e social të zonave e rajoneve të ndryshme, do të ndikojë mjaft në sigurimin e barazisë dhe aksesit në nivel kombëtar pra edhe për fëmijët e familjeve të varfëra apo grupeve të marginalizuara.

Per te thyer trashëgimine e varferise ne gjenerata, qeveria do t'i kushtoje vemendje te vecante formimit profesional te femijeve nga familjet e varfëra. Ne pergjigje te tendencave ekonomike, rajonale dhe tregut te punes, do t'i jepet prioritet arsimi profesional në kuadër të zhvillimit të arsimit parauniversitar. Qeveria do te hape nje sere shkollash profesionale ne zonat rurale, kryesisht per agro-biznesin, me qellim terheqjen e me shume se 40 perqind te nxenesve që përfundojnë arsimin bazë .

Reforma arsimore nepermjet programit “Barazi dhe Cilesi ne Arsimin Shqiptar” do te sjelle permiresimin e cilesise se kushteve te mesimit per te gjithë nxenesit dhe rritjen e rregjistrimeve ne arsimin e mesem, sidomos per te varferit. Do te perditesohet programi mesimor (rishikimi i kurrikules se arsimit baze gjate vitit 2008 dhe i arsimit te mesem deri ne vitin 2010) dhe do permiresohet kualifikimi i mesuesve per te bere te mundur qe nxenesit te fitojne aftesite e duhura per tregun e punes. Ne mbështetje te kurrikules se re, do te sigurohen laboratore shkencore dhe mjete informatike. Do te rritet autonomia e shkolles, duke u dhene mundesi shkollave te gjejne zgjidhje per nevojat e komuniteteve te tyre. Do te kete permiresim dhe racionalizim te infrastructures arsimore ne arsimin e mesem. Do te behen me shume investime te efektshme ne infrastrukturen fizike dhe burimet njerezore sipas nevojave te shkollave duke patur parasysh dhe demografine.

Synimet:

- Deri ne vitin 2010 financimi i arsimit do te jete 5 perqind e GDP
- Deri ne vitin 2015 arsimimi jetik i te rinjve parashikohet te jete mesatarisht 13 vite.
- Deri ne vitin 2009 , 40 perqind e popullsise nga 15-24 vjeç që ka përfunduar arsimin e detyruar 8-vjeçar , do te kene nivelin me te larte te arsimit ISCED 0, 1, 2.

Modernizimi i Asistences Sociale

Situata

Programet e mbrojtjes sociale kane nje ndikim te rendesishem ne reduktimin e varferise ne Shqiperi. Sistemi i mbrojtjes sociale ne Shqiperi perfshin (i) skemen e sigurimeve shoqerore mbi bazen e kontributeve (pensionet); (ii) programe te tregut te punes te financuara nga te ardhurat dhe (iii) asistences sociale ne formen e transfertave nga buxheti i shtetit.

Vlera totale e transfertave publike per mbrojtjen sociale perben 28 perqind te konsumit te me te varferve nga 20 perqind e familjeve rurale, dhe 38 perqind te konsumit te me te varferve te 20 perqind te familjeve te zonave urbane. Ne mungese te programeve te mbrojtjes sociale, norma e varferise do te kishte qene 11 perqind me e larte per popullsine dhe 20 perqind me e larte per perfituesit.¹⁶

Ne fushen e asistences sociale, shteti ofron:

Ndihme Ekonomike, ndihmon mesatarisht 114,000 familje me nje pagese mujore cash, 65,000 e te cileve jane nga zonat rurale dhe 49,000 nga zonat urbane (2005). Ndhma Ekonomike jepet ne nivelin me te ulet apo nivel te mesem per 57 perqind te familjeve (sidomos ne zonat rurale) dhe ne nivel me te larte per 43 perqind te familjeve (sidomos ne qytet). Me permiresimin e situates ekonomike keto 5 vitet e fundit, numri i perfituesve eshte ne renie. Fondet e asistences ekonomike kane rene nga 4 bilion lek ne 2.8 bilion lek. Ulja e numrit te familjeve perfituese te NE me rreth 35 mije ne kater vitet e fundit eshte shoqeruar edhe me uljen e fondeve pra, nuk eshte kuptuar si nje mundesi per te rritur masen e NE per uljen e varferise.

Mbulimi i me te varferve eshte rritur por ka probleme me masen e ndihmes ekonomike e cila mbulon pjeserisht nevojat e familjeve te varfera (67 perqind e tyre nuk mbulohen). Vlera reale e pageses eshte ulur me 27 perqind ne zonat urbane dhe 17 perqind ne zonat rurale dhe mesatarisht perben 15 perqind te kufirit te varferise.¹⁷ Masa mesatare e NE/familje ne 2006 ka rene me 23% kundrejt vitit me te larte ne 5 vitet e fundit.

Pagesa e Paafetise per personat me aftesi te kufizuar eshte programi me i madh i asistences sociale me nje shtrirje te shpejte te perfituesve ne keto vitet e fundit (shih me poshte PAK). Shpenzimet reale per programin jane pothuajse dyfishuar nga viti 2000 ne vitin 2005 dhe vlera reale e perfitimit eshte rritur me 60 perqind.¹⁸ Aktualisht eshte bere rivleresimi i kriterave te afetise se kufizuar. Personat qe jane bere te paafte gjate nje aksidenti ne pune dhe qe kane kontribuar ne skemen e sigurimeve shoqerore, perfitojne nje pension invaliditeti nga kontributi i tyre ne Institutin e Sigurimeve Shoqerore si dhe nje shtese mbi pensionin e invaliditetit per aftesin e tyre te kufizuar.

Vitet e fundit eshte futur skema e subvencionimit te energjiqe elektrike, per te varferit dhe PAK. Zbatimi ka qene i veshtire dhe i ngadalte. Nga Janari ne Mars 2006, vetem 37,000 familje nga 191,500 te synuara, kane perfituar subvencion.

Detyra e Politikes: Te siguroje qe ndihma ekonomike eshte targetuar tek familjet dhe personat me ne nevojte, gje e cila kontribuon edhe ne vleresimin e punes.

Masat

Po zbatohet ligji per Ndhmen dhe Sherbimet Shoqerore (2005). Ai zgjeron kufijte per pagesat e te gjitha grupeve ne nevojte, krijon hapesiren e duhur per decentralizim dhe zgjeron kompetencat e pushtetit lokal dhe pjesemarrjen e shoqerise civile ne sigurimin e sherbimeve te kujdesit social.

Sipas ketij ligji, per Ndhmen Ekonomike jane targetuar ne vecanti dy grupe:

- Prinder te trenjakeve qe mbeshteten me nje pagese mujore derisa femijet te mbarojne arsimin e detyruar.

¹⁶ World Bank PEIR, 2006

¹⁷ World Bank PEIR, 2006

¹⁸ ibid

- Jetimet e moshes 18-25 vjec qe kane dale jashte institucioneve dhe jetimet mbi 25 vjec dhe te papune (me pare ne institucione) te cileve u jepet nje pagese e vecante prej 3000 lek ne muaj.

Niveli minimal i Ndhmes Ekonomike u rrit nga 500 lek ne 800 lek ne muaj dhe niveli maksimal nga 6500 lek ne 7000 lek ne muaj.

Reformimi i skemes se NE synon reduktimin e shkalles se varferise ne perputhje me linjen e varferise absolute e cila në vitin 2015 parashikohet të arrijë në 10 % të popullsisë, rritjen e mbulimit të nevojave baze jetike te individeve dhe familjeve në përputhje me varfërinë absolute (2 \$ në ditë për person), percaktimin e numrit te personave dhe te familjeve në perputhje me konceptin e varfërisë dhe matësit e saj dhe mbi kete baze llogaritjen e bllokndihmes për çdo njësi vendore; thjeshtimin e dokumentacionit per identifikimin e familjeve nga pushteti vendor; kushtezimin e perfitimit te NE me pune komunitare dhe perfitimet nga programet e tjera sociale si dhe kontrollin efektiv te përdorimit të fondeve.

Subvencioni per energji ne eshte rritur nga 9 perqind e cmimit ne 36 perqind dhe do t'i jepet 270,000 familjeve ne nevojë si dhe nepunesve buxhetore te paguar me pak se 35,000 lek ne muaj por qe plotesojne disa kushte si p.sh. jane te vetmit te punesuar ne familjet e tyre dhe vetem ata e perfitojne subvencionin.

Synimet :

- **Rritja e nivelit dhe mbulimit me perfitime**

Deri në vitin 2013, masa e ndihmës ekonomike për familje do të tentojë arritjen e treguesit të nivelit të varfërisë, brenda një kufiri tavan që nuk e kalon nivelin e pensionit minimal në shkallë vendi.

Ne 2013 synohet qe nr i familjeve qe perfitojne ndihme ekonomike te jete 70000.

- **Permiresimi i vleresimit te perfituesve per familjet aplikante**
- **Kushtezimi i perfituesve te ndihmes ekonomike me pune ne komunitet**

Aksesi tek Sherbimet

Infrastruktura e shperndarjes se sherbimeve publike, ku perfshihen sherbimet e kujdesit social, sherbimi shendetsor dhe arsimor, eshte shume e varfer ne zonat rurale, sidomos ne zonat urbane dhe peri-urbane ku ka vendbanime te medha informale per shkak te migracionit te brendshem. Shkaterrimi i infrastruktures se viteve nentedhjete dhe migracioni i profesionisteve e kane renduar situaten. Eshte vene ne zbatim politika e decentralizimit te shperndarjes se sherbimeve ne disa sektore si shendetsia, arsimi dhe sherbimet sociale.¹⁹ Sidoqofte formulat tradicionale qe jane perdorur per alokimin e investimeve dhe te shpenzimeve korrente nga pushteti qendror ne pushtetin lokal, nuk jane te lidhura domosdoshmerisht me nevojat e te varferve. Duhet ngritur kapacitetet per monitorimin e shperndarjes se sherbimeve nga pushteti lokal apo monitorimin e shpenzimeve atje ku jane vene ne zbatim politikat per reduktimin e perjashtimit social. Pervec strategjive sektoriale perkatese, strategjite ndersektoriale te zhvillimit rural dhe zhvillimit rajonal do te permiresojne aksesin tek sherbimet.

¹⁹ Strategjia Kombetare per Decentralizimin dhe Autonomine Lokale 1999

Perkujdesi Social

Situata

Tradicionalisht, Shqipëria nuk e ka përdorur institucionalizimin e perkujdesit social si një mënyrë për të siguruar shërbime për të moshuarit, jetimet apo personat me aftësi të kufizuara. Në të gjithë vendin ka 26 institucione (23 rezidenciale). Duke qenë të vendosura në qendrat me të mëdha urbane nevojat për shërbime në zonat me të largëta plotësohen pjesërisht. Këto shërbime aktualisht ofrohen nga pushteti qendror dhe janë në procesin e decentralizimit drejt pushtetit lokal.

Shërbimet ekzistuese me bazë komunitare ofrohen nga OJF-ndërkombëtare dhe lokale. Por edhe këto shërbime janë të përqendruara kryesisht në Tiranë dhe në qytetet me infrastrukturë me të mirë apo në zonat ku OJF-të janë me aktive dhe kanë kapacitete për të thithur fondet. Gjithsesi ka munguar një kuader rregullues për shërbimet e ngritura nga OJF-të.

Detyra e politikës: Përmirësimi i shërbimeve rezidenciale dhe zhvillimi i shërbimeve mbështetëse ditore brenda familjes si dhe zhvillimi i shërbimeve me bazë komunitare në të gjithë vendin.

Masat

Strategjia e Mbrojtjes Sociale (2008-2013) dhe Ligji për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore (2005) i hap rruge deinstitutionalizimit dhe decentralizimit të institucioneve të kujdesit drejt pushtetit lokal, ku shërbimet do të jenë me afër familjes dhe komunitetit. Kjo reformë do të inkurajojë shoqërinë civile në sigurimin dhe zhvillimin e shërbimeve të reja të kujdesit social në partneritet me pushtetin lokal. Shërbimet rezidenciale u zhvilluan nën Projektin e Shërbimeve Sociale, për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe shtrirjen e funksioneve të tyre për të përfshirë edhe kujdesin ditë. Gjatë vitit 2007 janë ngritur 27 shërbime të tjera komunitare, të cilat shtrihen në 8 qarqe të vendit. Në këtë mënyrë mbulohet 2/3 e territorit të vendit me modelin e ri të shërbimeve komunitare.

Midis pushtetit dhe ofruesve private do të ketë marrëveshje kontraktuale. Ngritja dhe monitorimi i standarteve të shërbimeve do të bëjë të mundur përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që ofrohen. Kohët e fundit janë ngritur Komisionet Rajonale të Shërbimit Social. Këto janë partneritete ndërmjet qeverisë, OJF-ve dhe bizneseve për të parë nevojat lokale dhe për të gjetur një mënyrë financimi.²⁰

Strategjia e Mbrojtjes Sociale propozon ngritjen e Fondit Social nga viti 2008, për të mundësuar marrjen e granteve mbi bazë bashke financimi për Pushtetin Lokal dhe OJF-të duke ngritur shërbime të kujdesit social në komunitet. Financimi do të bëhet nga donatorët, ndërmarrjet private dhe kontributi i qeverisë.

Synimi :

- Në periudhën 2008-2013 do të përfundojë procesi i deinstitutionalizimit të shërbimit të femijëve.
- Deri në 2009 do të kemi shërbime të reja të tipit në familje.

²⁰ VKM 563 Përcaktimi i Përgjegjësisë të Qarkut në Ngritjen e Shërbimeve Sociale

Shendetsia

Situata

Sektori i Shendetsise eshte nje nga prioritet e qeverise. Financimi i shendetsise eshte i ulet, gje qe rrit rrezikun e varferise. Ndersa ne vitin 2005, Shqiperia shpenzoi per sherbimet shendetsore rreth 6 perqind te GDP, shpenzimet e qeverise ishin vetem 2.5 perqind e GDP. Pjesa tjeter jane pagesa nga xhepi. Ne sektorin e shendetsise jane hartuar, rishikuar dhe ka filluar implementimi i Strategjise Afat-Gjate per Zhvillimin e Sistemit Shendetsor ne Shqiperi (2004), Strategjise se Shendetit Publik dhe Promocionit Shendetsor (2003) si dhe Strategjise se Shendetit Mendor dhe Planit te Veprimit (2005). Plani Kombetar per Femijet, Plani per Permiresimin e Kushteve te Jeteses se Romeve, Plani Kombetar per PAK, te gjitha permbajne angazhime per permiresimin e sherbimit shendetsor.

Shendetsia ne Shqiperi ka mbetur mbrapa vendeve te tjera te Europes. Jete gjatesia per shqiptaret eshte me e ulet sesa mesatarja Europiane. Perqindja e vdekshmerise foshnjore dhe tek nenat (sidomos ne zonat rurale) mbetet e larte ne krahasim me nivelin e vendeve Europiane (shih me poshte, Zbutja e Varferise se Femijeve).

Kushtet e keqia te jeteses ku perfshihet mbipopullimi, ambientet e papastra dhe ushqimi i keq, çojne ne nje status te ulet shendetsor, ku sherbimet e kujdesit shendetsor nuk kane mundesi t'i pergjigjen gje qe kerkon rritjen e aksesit ne sherbimet e kujdesit shendetsor dhe permiresimin e cilesise. Incidenca e tuberkulozit ne Shqiperi, pavaresisht se mbetet e larte nuk eshte ne rritje por ecen paralelisht me vendet e tjera te botes. Shqiperia ka filluar te kete me shume raste te semundjeve kronike. Duhani, alkooli, dhe hipertensioni jane barra me e rende e semundjeve tek burrat ne Shqiperi, dhe hipertensioni e BMI (obesiteti) i larte tek grate. Ministria e Shendetsise ka marre masa per mbrojtjen e shendetit ndaj produkteve te duhanit nepermjet miratimit te Ligjit "Per mbrojtjen e shendetit nga produktet e duhanit" ne 27 Maj 2007 dhe venies ne zbatim te ketij Ligji.

Migrimi nga zonat rurale ne zonat urbane ne fillimin e viteve 1990 dhe ne pergjithesi periudha e tranzicionit solli ndryshimin e sistemit shendetsor ne Shqiperi dhe cilesise se sherbimit te sistemit te kujdesit shendetsor, sidomos atij paresor. Sot, kujdesi paresor shendetsor sigurohet nepermjet nje rrjeti te gjere qendrash shendetsore ne zonat rurale dhe urbane. Ka patur pakesim te madh te personelit qe punon ne zonat e largeta dhe humbje te personelit te kualifikuar drejt sektorit privat apo per shkak te emigracionit. Eshte perfunduar procesi i mbulimit te vendit me qendra shendetsore . Deri ne vitin 2012 eshte planifikuar te jete mbaruar investimi ne infrastrukturen e ambulancave ne shkalle vendi.

Per shendetin mendor ka mungese sherbimesh (shendetsore dhe sociale) per te rriturit dhe femijet dhe shume pak mbeshtetje per kujdestaret. Ka nevojte per te ngritur kapacitete dhe per te zhvilluar burimet njerezore si dhe alternativa te reja te tilla si qendrat komunitare te shendetit mendor, qendra te mbrojtura per qendrim afat gjate, qendra ditore dhe kujdes shendetsor per grupe te vecanta sic jane femijet dhe te moshuarit.

Tarifat informale per ofruesit e sherbimeve shendetsore sjellin pabarazi dhe akses te pakot ne kujdesin shendetsor. Ato jane sfida kryesore per permiresimin e cilesise se sherbimeve, dhe efikasitetin e sektorit. Ndersa shpenzimet per kujdesin ambulator kane ndikim me te madh mbi varferine sepse jane me te kerkuara, shpenzimi i familjeve me te ardhura te pakta kur kane nevojte per shtrim ne spital, mund te jete shume i madh – me nje mesatare pagese per shtrim, kater here me shume se paga mujore per fryme e 20 perqindshit me te varfer te popullsise.²¹

²¹ World Bank PEIR, 2006

Detyra e politikës: Sigurimi i aksesit të popullsisë në shërbimet kryesore të kujdesit shëndetësor dhe mbrojtja nga efektet varferuese të shpenzimeve për shëndetin.

Masat

Qeveria është angazhuar të sigurojë një akses të garantuar, shërbim shëndetësor cilësor dhe të ndërsjellshëm për të gjithë dhe ky do të jetë edhe qëllimi i Strategjisë së re të Sektorit Shëndetësor.

Draft ligji mbi "Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", do të forcojë reformat aktuale në sektorin shëndetësor dhe do të mbulojë çështjet e mëposhtme të rëndësishme për përfshirjen sociale:

- Reformën e kujdesit përsor shëndetësor për përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe rritjen e mbulimit në të gjithë vendin, duke i kushtuar kujdes të vecantë shëndetit të nënës dhe fëmijës dhe planifikimit familjar.
- Parandalimin e marrjes së pagesave informale nga stafi mjekësor.
- Reforma dhe modernizimi i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Përsor (sektori publik) nepermjet rritjes së autonomisë së Qendrave Shëndetësore.
- Programe për parandalimin e sëmundjeve; sidomos programi i vaksinimit, përveç promovimit të shërbimeve shëndetësore është prioritet promovimi dhe edukimi shëndetësor nga ana e specialistëve përkatës, monitorimit të ujit të pijshëm dhe kontrollit të cilësisë së ajrit.
- Shërbime të vecanta dhe/ose ulje të tarifave dhe çmimeve për shërbimet shëndetësore dhe mjekimeve për grupet e synuara. Grupet do të përfshijnë, nënat dhe fëmijet në nevojë, PAK, pensionistet, etj.

Është propozuar edhe një draft ligj që Autoritetet Shëndetësore Rajonale të planifikojnë dhe mbikëqyrin vënie në funksionim të shërbimeve të kujdesit përsor në zonën e tyre, ndërsa Ministria e Shëndetësisë do të bëjë menaxhimin e rrjetit spitalor.

Reforma në financimin e shëndetësisë nepermjet Institutit të Sigurimit Shëndetësor, si blerësi i vetëm i shërbimeve shëndetësore, do të përmirësojë ecurinë e sistemit shëndetësor. Projekti Proshëndetit i financuar nga USAID ofron një model të ri financimi për shërbimet e kujdesit shëndetësor nepermjet Skemës së Sigurimit Shëndetësor. Ky projekt pilot ka nisur në Berat dhe është shtrirë në të gjithë vendin. Shëndeti riprodhues është prioritet dhe është organizuar shpërndarja e kontraceptiveve falas nga qendrat shëndetësore. Aktualisht, qeveria financon plotësisht programin e vaksinimit masiv dhe po zbaton Planin Kombëtar të Imunizimit 2001-2010 për të siguruar mbulimin e plotë.

Politika e Shëndetit Mendor dhe Plani i Veprimit do të përdorin burimet ekzistuese shëndetësore dhe të sektorit social duke përfshirë edhe pushtetin lokal, për të siguruar akses tek shërbimet e shëndetit mendor, të krahasueshme me standartet ndërkombëtare. Aktivitetet lidhen me deinstitutionalizimin e spitaleve psikiatrike nepermjet shtrirjes së shërbimeve të shëndetit mendor për të siguruar kujdes multidisiplinor në komunitet. Gjashtë shërbime të shëndetit mendor po veprojnë mbi bazën e metodës komunitare të shërbimit shëndetësor mendor të mbështetura nga donatorët.

Synimet

- Deri në vitin 2009, shkalla e vdekshmërisë amtare për 100 mijë lindje të gjalla do të jetë 12.
- Deri në vitin 2009, shkalla e vdekshmërisë foshnjore për 1000 lindje të gjalla do të jetë 11.

Strehimi

Situata

Ne fund te epokes se komunizmit, Shqiperia kishte nje nga nivelet me te ulta ne Europe te sigurimit te strehimit. Ne keto 15 vitet e fundit, Shqiperia ka kaluar ne nje transformim te shpejte social dhe ekonomik. Deri ne vitin 1995, ne vazhdim te reformes se vitit 1993 ne strehim, 98 perqind nga 238,700 familje privatizuan banesat pothuajse falas. Privatizimi u erdhi ne ndihme familjeve me te ardhura te pakta, por fatkeqesisht shume prej tyre nuk kishin patur mundesi financiare per t'i mirembajtur banesat. Enti Kombetar i Banesave, i ngritur ne vitin 1993 nderton ose ble apartamente per t'ua shitur atyre, qe ne vitin 1993 ishin regjistruar si te pastrehe, por kjo kategori te pastrehesh nuk eshte domosdoshmerisht e varfer.

Migrantet nga zonat rurale jane vendosur ne periferi te zonave urbane, duke ndertuar ne menyre informale ne toka te lira. Rezultati eshte qe cilesia e strehimit dhe madhesia e siperfaqes se perdorur, eshte ne rritje per te gjitha grupet. Sipas te dhenave te Rregjistrimit te Popullise te vitit 1989, ne nje dhome jetonin 2.7 fryme. LSMS e vitit 2002 dhe 2005 tregon qe densiteti eshte ulur deri ne 2.25 fryme per dhome megjithese perseri ky nivel mbetet me i larte se ai i vendeve te tjera te Europes. LSMS e vitit 2002 dhe 2005 tregon se siperfaqja e banimit eshte rritur me pothuaj 20 m² ne vitin 2005, nje rritje prej 3 m² per njeri ne krahasim me vitin 2002, qe e sjell kete parameter ne kufijte e zakonshem te vendeve te Europes Qendrore dhe Lindore.

Nepermjet ndertimeve ilegale, familjet kryesisht te ardhur nga zona te ndryshme te vendit paten mundesi te siguronin nje lloje pasurie, por megjithate keto ndertime jane ne periferi te qyteteve dhe jane shoqeruar me mungese infrastrukture dhe hapesire te pamjaftueshme per ndertimin e rrugeve. Te dhenat nga vezhgimet e fundit, tregojne se vitet e fundit kosto e strehimit eshte rritur dhe se sigurimi i strehimit per te varferit eshte ne renie. Nje tjetër problem i madh per familjet me te ardhura te pakta ne Shqiperi, eshte perqindja shume e ulet ne treg e shtepive me qera, qe vleresohet 5% ne krahasim me 30-50% qe eshte ne shumicen e ekonomive te tregut.²²

Tregu formal i pronave te patundshme eshte duke u rritur, por eshte i kufizuar nga tre faktore kryesore:

- Mungesa e master planeve dhe akteve nenligjore te miratuara ne nivel lokal
- Mungesa e programeve te financuara nga bashkite per ndertimin e infrastruktures baze
- Pamundesia de facto per blerjen e tokave te pashfrytezuara per t'i shfrytezuar.²³

Probleme ka edhe me pamundesine e atyre qe jane realisht te varfer per te blere shtepi, me shtrirjen e ndertimeve pa leje, institucionet e dobta dhe mungesen e respektit per shtetin ligjor.

Detyra e politikës : Sigurimi i strehimit social per familje me te ardhura te ulta dhe zhvillimi i institucioneve rregullatore dhe sektorit financiar per sigurimin e aksesit per strehimin e shtresave me te ardhura te pakta.

²² Bertaud 2006

²³ ibid

Masat

Synimi i politikës së strehimit është zhvillimi i një klime të favorshme, ligjore, fiskale dhe financiare për zhvillimin e tregut të lire, rritjen e ofertes për strehim të përballueshëm financiarisht, shpërndarjen e subvencioneve direkte për familjet me të ardhura të pakta dhe grupet vulnerabel, nxitjen e programeve të ringjalljes urbane dhe programeve të modernizimit të mirëmbajtjes së ndërtesave, rritjen e kapaciteteve të pushtetit lokal për menaxhimin e problemeve të strehimit dhe inkurajimin e partneriteteve multi-laterale ndërmjet sektorit publik (qendror dhe lokal), dhe atij privat (fitimprures dhe jo-fitimprures) dhe komunitetit. Me minimizimin e rolit të shtetit në strehim, objektivi i politikave të strehimit është identifikimi i grupeve të synuara për t'u dhënë atyre ndihmë dhe mundësi për mbështetje financiare për strehim me qellim përfitimin e pronësive, që ka shumë vlerë në shoqërinë shqiptare. Detaje të veprimtarive për Romët trajtohen në seksionin përkatës më poshtë.

Strategjia Kombëtare e Strehimit ka tre prioritet kryesorë:

1. Aksesin për të varfërit për kushte strehimi të përshtatshme ku përfshihet strehimi social me qera të ulët;
2. Zhvillimi i sektorit financiar për strehimin dhe partneritetet publike-private për të ofruar strehim të mundshëm financiarisht
3. Stimulimi i programeve për mirëmbajtje dhe përmirësime në strehim.

Një nga prioritetet afat-mesme është përcaktimi i standardeve të reja në lidhje me politikat e strehimit. Në këtë kuader, do të rishikohet e drejta për strehim sipas standardeve ndërkombëtare dhe Europiane si dhe vlera financiare mesatare e një banese tip, me qëllim që të bëhet vlerësimi i mundësive të banorëve për t'u strehuar.

Qeveria ka marrë angazhim për përfundimin e procesit të legalizimit të shtëpive, në vecanti në zonat urbane ku ka ndërtime të reja. Për legalizimin e shtëpive dhe fitimin e titullit të pronësive, qytetarët duhet të paguajnë nga 100-400 mijë leke. Ky proces do të favorizojë njerezit në nevojë. Qeveria gjithashtu është angazhuar të kompensojë pronarët e tokës. Legalizimi i ndërtesave të pa autorizuar gjatë lëshimit të lejeve të ndërtimit fillimisht do të bëhet duke vendosur një gjohë prej 4 përqind mbi vlerën e tregut. Duke i analizuar rast pas rasti, zonat me ndërtime pa leje do të zhvillohen dhe urbanizohen nëpërmjet investimeve në infrastrukturë dhe shërbimet bazë të tilla si arsimi dhe shëndetsia. Gjatë gjithë këtij procesi, duhet të bëhet diferencim ndërmjet ndërtimeve pa leje për nevojat sociale dhe atyre për qellime përfitimi personal, duke ndeshkuar këta të fundit.

Jane duke u vënë në zbatim iniciativat për sigurimin e infrastrukturës bazë. Decentralizimi nënkupton që pushtetit lokal i është dhënë një rol më i madh për të formuluar ligje të përshtatshme dhe për t'i zbatuar ato, për formulimin e planeve urbanistike, për përcaktimin e një takse lokale bazë për infrastrukturën dhe shërbimet dhe për tërheqjen e financimeve për infrastrukturën bazë. Banka Botërore ka financuar një projekt \$20 milion për Menaxhimin e Tokës dhe Zhvillimin Urban që përmirëson efikasitetin e tokës dhe tregjeve të pronës nëpërmjet një sigurie më të madhe për pronën dhe rregullave më të mira për menaxhimin e tokës, si dhe zbatimin rigoroz të këtyre rregullave.

Synimi

- Rritja e sipërfaqes së banimit për person
- Banesat sociale me qera do të përbejnë të paktën 1% të fondit të përgjithshëm të banesave
- Banesat me kosto të ulët do të përbejnë rreth 5% të fondit të përgjithshëm të banesave nëpërmjet skemave të partneritetit
- Rehabilitimi deri në masën 50% i vendbanimeve të komunitetit rom

Asistenca Ligjore

Situata

Aktualisht shteti nuk ofron asistence ligjore per rastet civile. Shoqata per Asistence Ligjore Falas ne Tirane (TLAS) filloi aktivitetin ne Shqiperi ne vitin 1999 si nje OJF qe ofronte asistence ligjore per rastet civile. Nder grupet me te medha te perfituesve te TLAS jane minoritetet, te migruarit ne vitet e demokracise, invalidet dhe personat me aftesi te kufizuara, pensionistet, te papunet dhe familjet e tjera me te ardhura te pakta. Nga 6,500 kliente qe jane asistuar nga kjo OJF, 60 perqind kane probleme qe mund te zgjidhen me anen e keshillimit ose duke u dhene mbeshtetje direkte, nje shembull i tille mund te jete rregjistrimi per NE. Pjesa tjeter prej 40 perqind kane qene raste per perfaqesim ne gjyq ku 88 perqind e rasteve kane rezultuar te suksesshme. Ka edhe dy OJF te tjera qe ofrojne asistence ligjore- Qendra Avokatore per Grate qe merret me raste ligjore per grate dhe familjet, dhe Klinika e Minoreneve qe merret me raste qe perbejne veper penale per femijet. Disa organizata ofrojne asistence ligjore si pjese e misionit, por ky nuk eshte i vetmi sherbim. Nje shembull eshte Fondacioni per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar qe vitin e fundit ka filluar te ofrojë sherbime ligjore per personat me aftesi te kufizuar.

Probleme ne drejtim te ndihmes ligjore per personat ne nevojë ka edhe ne fushen e ndihmes ligjore per ceshtjet penale. Aktualisht kjo ndihme karakterizohet nga formalizmi dhe mungesa e cilesise se mbrojtjes.

Ne kuadrin e zbatimit te Kushtetutes dhe angazhimeve ndërkombëtare të RSH si palë pjesmarrëse në Koventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, per rastet kriminale qeveria do te ofroje asistence ligjore edhe per grupet ne nevojë. Sidoqofte procedurat komplekse, pagesat e ulta dhe te vonuara, bejne qe shpesh njerezit te mos perfaqesohen apo te perfaqesohen keq. Te dhenat per numrin e njerezve qe marin asistence ligjore jane te veshtira per tu gjetur.

Detyra e politikës: Ofrimi i nje procesi ligjor te drejte per cdo qytetar

Masat

Per garantimin e nje procesi te drejte ligjor per cdo qytetar, akses ne drejtesi, drejtesi dhe barazi para ligjit per te gjithë qytetaret, trajtim njerezor gjate periudhes se burgimit dhe transformimin e ndeshkimit penal ne mundesi per riedukim, nevojitet transformim rrenjesor. Qeverise i eshte propozuar percaktimi i nje kuadri ligjor dhe strategjise se asistences ligjore per rastet civile. Ky rregullim perben një domosdoshmëri për të siguruar mundësi reale për njerëzit në nevojë për të realizuar të drejtat e njohura nga ligji.

Synimi

- Institucionalizimi i asistences ligjore falas per grupet ne nevojë.

Furnizimi me Uje dhe Higjena

Shqiperia ka burime ujore te mjaftueshme per te siguruar nje furnizim te bollshem dhe cilesor te popullsise me uje te pijshem. Megjithë nderhyrjet e medha qe jane bere deri tani, situata e furnizimit me uje te popullsise nuk eshte ne nivelin e kerkuar. Perqindja e popullsise qe ka akses ne furnizimin me uje eshte e papercaktuar. Te dhenat ndryshojne ne menyre te konsiderueshme, nga 90-97% ne zonat urbane ne 50-67% ne ato rurale. Konsumi i ujit ndahet ne 75% perdorues shtepiake dhe 25% jo-shtepiake. Uji i pallogaritur sipas te dhenave zyrtare eshte rreth 64% e ujit te prodhuar. Rreth 34% e prodhimit te ujit faturohet dhe nga kjo vetem 73.5% paguhet. Pra, aktualisht paguhet vetem 27.7% e prodhimit te pergjithshem te ujit. Humbjet e ujit jane per shkak te gjendjes se amortizuar te

infrastruktura se ujit, e cila eshte e vjeter dhe ka nevojte te riparohet, per shkak te mungeses se matesave, te lidhjeve te paligjshme dhe urbanizimit te pakontrolluar.

Persa i takon aksesit ne rjetin e kanalizimeve, rezulton se vetem 50 perqind e popullsise eshte e lidhur me rjetin e kanalizimeve ujore. Banoret e zonave rurale perdorin gropat septike dhe menyra te tjera. Ne shume zona, sistemi i kanalizimeve nuk funksionon dhe ndotja e ujit te pishem eshte nje rrezik i mundshem.

Aktualisht, ekziston vetem nje impiant i trajtimit te ujerave te zeza ne Shqiperi, ai i Kavajes financuar nga KfW. Te tjere jane ne fillimet e punimeve per ndertimin e tyre si ne Durres, Lezhe, Sarande, Durres, Korce, Pogradec dhe Velipoje, ne fshatrat Shirokë e Zogaj. Megjithate shkarkimet e ujrave te zeza vecanerisht ne afersi te zonave turistike dhe ekosistemeve delikate po behet shqetesues per komunitetin e biznesit dhe ambientalistet. Donatoret e huaj kane financuar studime per te siguruar zgjidhje te qendrueshme per te minimizuar efektin negativ te derdhjes se ujerave te zeza ne det dhe liqenet e vendit. Keto projekte kane per qellim te rrisin bazat ligjore dhe logjistike per ruajtjen e cilesise se ujrave te tyre, nepermjet zhvillimit te nje strategjie te mirefilte te manaxhimit te mjedisit te ujrave te detit dhe liqeneve dhe monitorimin e cilesise se ujit te tyre

Nderkohe qe Shqiperia ka pranuar standartet nderkombetare per cilesine e ujit, veshtiresia per t'i respektuar keto standarde eshte e madhe per shkak te infrastruktures te amortizuar, mungeses se trajtimit te ujrave te zeza si dhe mungeses se pajisjeve apo ekspertizes. Nje vezhgim i Bankes Boterore tregon qe nevojat per investime vleresohen ne rreth 170 milion USD ne vit, per cdo vit ne dekadën e ardhshme.

Analiza e varferise dhe ndikimit social, qe eshte bere per Strategjine e Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve konstaton se familjet e varfera qe jane vendosur ne rrethinat e qytetit dhe nderesa te reja, jane me pak te prirura per te paguar per sherbimin e furnizimit me uje. Furnizimi me uje ne zonat rurale eshte nje nga problemet me te cilin ballafaqohen komunitetet ne keto zona. Historikisht, per zonat rurale fondet e investimeve kane qene me te pakta dhe per rrjedhoje kjo reflektohet nga niveli i ulet sherbimit ne keto zona.

Detyra e politikës: Furnizimi i vazhdueshem me uje dhe nje higjene e qendrueshme sipas standardeve te BE ne zonat rurale dhe urbane.

Masat

Qeveria ka per synim te arrije furnizimin e vazhdueshem me uje dhe sherbimin e higjenes sipas standardeve te BE ne zonat rurale dhe urbane. Strategjia e Furnizimit me Uje dhe i Kanalizimeve ka prekur dy probleme: furnizimin e parregullt me uje dhe cilesine e dobete te ujit. Mendohet qe rritja e tarifave te ujit dhe kanalizimeve per te mbuluar kostot operationale dhe te mirembajtjes, do te shoqerohet me futjen ne perdorim te skemes per te synuar mbrojtjen e shtresave ne nevojte, duke aplikuar tarifa mbeshtetese per te subvencionuar direkt klientet e varfer.

Me ndihmen e komunitetit nderkombetar, jane marre masa te forta per forcimin e disiplines se sektorit, pakesimin e lidhjeve ilegale dhe harxhimin pa kriter te ujit te pijshem; rritjen e performances menaxheriale dhe financiare te kompanive qe kryejne furnizimin me uje. Duke mbeshtetur procesin e decentralizimit, qeveria do te mbeshtete bashkite dhe komunat per te rritur cilesine dhe sasine e ketij sherbimi ne menyre autonome dhe ne te njejtën kohe, duke i inkurajuar qe te fillojne gradualisht mbulimin e kosos se sherbimit. Po keshtu, qeveria do te krijojte mundesi per terheqjen e kapitalit privat ne kete sektor nepermjet koncesionit dhe kontratave per menaxhim. Aktualisht u miratua kalimi i ndermarrjeve te ujesjelles-kanalizimeve ne varesi te pushtetit vendor, nepermjet nje Plani Kombetar Veprimi.

Ne zonat rurale, permiresimet lidhen edhe me procesin e decentralizimit ne te cilin pushteti lokal do te pergjigjet per funksionimin e furnizimit me uje. Strategjia Rurale e Furnizimit me Uje dhe e Higjenes, ka synimin per te ndryshuar menyren e shperndarjes se ujit nga ana e shtetit.

Synimet

- Deri ne vitin 2009, 94 perqind e popullsisë urbane do te kete akses ne ujin e pishem.
- Deri ne vitin 2009, 55 perqind e popullsisë ne zonat rurale do te jete e mbuluar me uje te pijshem.
- Deri ne vitin 2009, 47% e popullsisë rurale do te jete e lidhur me rrjetin e kanalizimeve
- 12 orë do të jetë mesatarja e furnizimit me ujë e popullatës.

Transporti

Situata

Pemiresimi i rrjetit rrugor rural eshte kritik per zhvillimin ekonomik te zonave rurale dhe zbutjen e varferise. Rrjeti rrugor u krijon mundesi njerezve te arrijne tregjet dhe te marrin informacion, kujdes mjekesor dhe arsimim dhe gjithashtu u mundeson ketyre njerezve te levizin me lirshem atje ku ka me shume mundesi per te siguruar te ardhura. Rruget e kalueshme lehtësojnë sigurimin e shërbimeve sociale dhe janë një parakusht për investime ne rruget rurale.²⁴ Ndersa një numer rruges janë permiresuar me asistencë nga donatorët keto vitet e fundit dhe pjesa dermuese e ndërtimit dhe rehabilitimit të rrugëve rurale është kaluar ne kompetencat e komunave, perseri kushtet e rrugëve nuk kanë ndonjë permiresim te dukshem per zonat shume te largeta. Analizat e fundit nga Banka Boterore (2006) tregojne qe bashkite me te varfera marrin me pak fonde te kushtezuara per investime per rruget. Mirembajtja e rrugëve është e pakët edhe ne rruget e reja per shkak te mungeses se fondeve, kapacitetit dhe organizimit.

Edhe at'here kur rruget janë ne kushte te mira, transporti publik duhet te jete i aksesueshem per te moshuarit dhe personat me aftesi te kufizuar. Nuk ka shume informacion per aksesin e transportit publik nga grupet vulnerabel megjithë angazhimin e operatoreve te transportit publik per zbatimin e standarteve qe do te permiresojne aksesin.

Detyra e politikës: Sigurimi i aksesit ne transport per zonat rurale dhe ato urbane.

Masat

Strategjia e Transportit do te integrohet me një zhvillim te balancuar rajonal, zhvillim rural dhe perfshirje sociale.²⁵ Investime te konsiderueshme te parashikuara ne Planin Kombetar te Transportit do te sjellin permiresimin e korridoreve kryesore dhe mirembajtjen e rrugëve rurale. Ne bashkepunim me pushtetin lokal dhe duke respektuar autonomine lokale qeveria do te financoje permiresimin e infrastruktures rrugore te bashkive dhe komunave. Kjo do te ndikojë ne një akses me te madh tek kujdesi shëndetsor dhe arsimi, dhe do te krijojë me shume mundesi per zhvillimin e rrugëve rurale. Pjesëmarrja e komunave ne ndërtimin dhe mirembajtjen e rrugëve rurale konsiderohet kyc per te patur një rrjet rrugor rural te qendrueshem.

Jane marre angazhime per zbatimin e parimit 'jete pa barriera' per personat me aftesi te kufizuara.²⁶ Operatoret e certifikuar te transportit publik kanë detyrimin te bashkepusojne me

²⁴ Strategjia Rurale ne Shqiperi: Forcimi i Rritjes dhe Zhvillimit te Qendrueshem, Banka Boterore, 2002

²⁵ Bashke me Planin Kombetar te Transportit, shih edhe strategjite ndersektoriale per Zhvillimin Rural (pezull) dhe Zhvillimin Rajonal (pezull)

²⁶ Strategjia e Mbrojtjes Sociale dhe Plani Kombetar per PAK 2003-2014

personat me aftesi te kufizuara dhe te moshuarit per zbatimin e standardeve qe do te permiresojne aksesin ne transportin publik. Zbatimi i Planit Kombetar per Personat me Aftesi te Kufizuar do te beje te mundur lehtesimin e aksesit per personat me aftesi te kufizuar ne qytete. Personat e regjistruar si te paaftë kane transport falas brenda qytetit dhe cmim te reduktuar per transportin nderurban.

Synimi

- Deri ne vitin 2009 do te rehabilitohen dhe asfaltohen 4000 kilometra rruge rurale.

Telekomunikacioni

Situata

Telekomunikacioni dhe teknologjia e informacionit jane shume te rendesishme per nje zhvillim modern te integruar drejt Europes. Ajo qe trashëgoi Shqiperia deri ne vitin 1991 ishte gjendja e keqe e infrastruktures se telekomunikacionit. Akoma me e keqe eshte situata ne zonat rurale ku infrastruktura e Albletekomit eshte demtuar rende pas renies se komunizmit ne 1990-en, si dhe pas renies se skemave piramidale ne vitin 1997. Atje ku ekziston rrjeti kryesor rural perbehet kryesisht nga tela te lidhur ne ambient te hapur te cilet perfundojne ne zyrat e telekomit te komunave.²⁷ Operatoret private ne zonat rurale jane te licensuar dhe ofrojne akses ne sherbime telekomunikacioni.

Sherbimi i telefonise fikse aktualisht ofrohet nga Albletekom. Norma e penetrimit te linjave fikse/per person, ne Shqiperi mbetet nen masen 9 %, qe eshte nje e treta e normes se Bosnies dhe Hercegovines, Maqedonise, Serbise dhe Malit te Zi. Te verberit, dhe paraplegjiket e tetraplegjiket perfitojne tarifa te reduktuara dhe jane te perjashtuar nga taksa mujore e telefonise.

Penetrimi i telefonise celulare eshte 61 perqind dhe mbulimi shtrihet ne 90 perqind te popullates. Por per shkak te cmimit te larte te thirjeve me jashte, klientet e zonave rurale perdorin telefonat e tyre celulare per te marre thirrjet dhe pastaj kryejne telefonata nga telefonat fiks.²⁸

Detyra e politikës: Ofrimi i sherbimeve me tarifa te ulta, cilesi te larte dhe shumellojshmeri, per te gjithë.

Masat

Strategjia Kombetare e Teknologjise se Informacionit dhe Komunikacionit (2003) po zevendesohet me strategjine dhe legjislacionin e ri te Teknologjise se Informacionit dhe Komunikacionit, duke reflektuar tashme standarde Europiane. Kjo do te krijojë nje sektor te liberalizuar dhe plotesisht konkurues te mbështetur nga entet rregullatore, qe do te sigurojne akses per te gjithë ne telekomunikacion. Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT) ka bere tashme draftin e ligjit te Komunikimeve Elektronike dhe aktualisht eshte ne proces konsultimi. Albletekom tashme eshte privatizuar dhe ndarja eshte 75% nga Çelik Energji dhe 25% e zoteruar nga Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes

Synimi

- Deri ne vitin 2009 norma e penetrimit te linjave fikse për familje do të rritet ne 90 perqind.

²⁷ Shoqata Kombetare e Telekomunikacionit ne Shqiperi: Telekomunikacioni dhe Investimi I Sektorit Privat ne Aksesin ne zonat Rurale, 2003

²⁸ Shoqata Kombetare e Telekomunikacionit ne Shqiperi: Telekomunikacioni dhe Investimi I Sektorit Privat ne Aksesin ne zonat Rurale, 2003

Grupet e Prekshme dhe Fushat Specifike

Kushtetuta e Shqipërisë garanton barazi para ligjit, dhe liri nga diskriminimi mbi bazën e racës, gjinisë, etnisë dhe gjuhës. Disa grupe kanë nevojë për kujdesje të veçantë për shkak të situatës dhe të qenit të tyre të prekshëm ose vulnerabel.

Të qenit vulnerabel dhe rreziku i përjashtimit social ka bërë të mundur zhvillimin e planeve të veprimit dhe politikave kombëtare ndërsektoriale për fëmijet, Romët dhe personat me aftësi të kufizuara. Qeveria është gjithashtu në procesin e zhvillimit të politikave kombëtare dhe planeve të veprimit për barazim gjinorë dhe dhunën në familje.

Është i njohur fakti që në Shqipëri ekzistojnë grupe vulnerabel dhe grupe të rrezikuara. Nderkohe që rritja ekonomike do të vazhdojë të ndikojë në uljen e varfërisë dhe reformat e vazhdueshme në sektorin publik do të përmirësojnë aksesin tek shërbimet, vlerësimi i vulnerabilitetit do të vazhdojë t'i vijë në ndihmë shtetit në vlerësimin e prioritetëve për targetimin e asistencës.

Fëmijet e Rrezikuar

Situata

Gjatë periudhës së tranzicionit, Shqipëria ka bërë progres në drejtim të fëmijëve por shumë prej tyre mbeten të papërfshirë dhe të padukshëm. Në vitin 2005, 245,000 fëmijë jetonin në varfëri absolute (LSMS 2005). Rritja ekonomike ka çuar në pakesimin e fëmijëve që jetojnë në varfëri deri në 34 përqind që nga viti 2002. Këta fëmijë jetojnë në komunitetet me të harruara, zonat me të thella dhe disa të tjera në periferitë e qyteteve të mëdha. Këta janë fëmijet Romë, fëmijet pa kujdesin e prindërve, fëmijet me paafësi, fëmijet e trafikuar²⁹ dhe fëmijet që punojnë në rrugë. Ka dhe fëmijet që nuk janë domosdoshmërisht të varfër por që nuk janë të përfshirë – këta ndahen sipas gjinisë, etnisë apo paafesise.

Vdekshmëria tek fëmijet (numri i vdekjeve tek fëmijet deri në 1 vjeç për 1,000 lindje) ka patur rritje të madhe në 15 vitet e fundit, nga 35 përqind që ishte në vitin 1990 në 7,4 përqind në vitin 2006. Por sipas standarteve të BE kjo përqindje është akoma e lartë. Semundje të traktit të frymëmarrjes, fëmijëve dhe diarhësi janë ndër shkaqet kryesore të vdekshmërisë së fëmijëve. Këto janë me shumë rrjedhojë e mungesës së standarteve të jetesës, higjienës së ujit, mungesës së aksesit në shërbimet shëndetësore, mungesës së njohurive dhe trajnimit të personelit mjekësor në mjekimin e semundjeve të fëmijëve, mungesës së njohurive të mjaftueshme dhe informacionit përkatës nga ana e nënave, familjeve dhe komuniteteve në lidhje me rritjen e fëmijës, të ushqyerit dhe fëmijën.

Shqipëria ka një skemë vaksinimi të detyrueshme gjë që e mban normën e imunitetit tek fëmijet në shkallë të lartë kundër lijes, difterisë, tetanosit, tuberkulozit, poliomielitit, hepatitit B si dhe rubeolës. Studimet tregojnë se me shumë se 95% e fëmijëve vaksinohen, që është e krahasueshme me standartet e BE.³⁰ Sidoqoftë fëmijet nga disa grupe minoritare nuk vaksinohen ashtu si pjesa dërmuese e popullsisë.

Të ushqyerit e papershtatshëm për fëmijet i shoqëruar dhe me varfëri dhe mungesën e aksesit në shërbimet shëndetësore rezultojnë në mungesën e të ushqyerit tek fëmijet e moshës parashkollore. Njëzet e dy përqind e fëmijëve nën moshën 5 vjeç vuajnë nga të ushqyerit e keq kronik.

²⁹ Strategji dhe plane veprimi për parandalimin e trafikimit dhe shërbime të veçanta për viktimat e trafikimit janë pjesë e strategjise ndërsektoriale "Kunder Krimit të Organizuar, Anti-trafikimit dhe Anti-Terrorizmit"

³⁰ Profili i të Ushqyerit, FAO, 2005

Femijet ekspozohen ndaj shume rreziqeve mjedisore te tilla si ndotja e ujit dhe ajrit, grumbullimi i plehrave dhe mbetjeve urbane. Ata jane gjithashtu te rrezikuar nga ushqimi i infektuar, shtepite e rrenuara dhe te pabanueshme, trafikut rugor, etj.

Zhvillimi ne femijerine e hershme me nderhyrje per femijet e rrezikuar, eshte i rendesishem per arrijten e rezultateve ne arsim. Me pak se 50% e femijeve jane te regjistruar ne institucionet e femijerise se hershme, publike ose private.

Te dhena nga Shërbimet Sociale per vitin 2006 vleresojne se jane 2,275 femije ne institucione te perkujdesjes. Nje situatë e tille eshte e krahasueshme me ate te vendeve te tjera te rajonit.³¹ Ka te dhena te pamjaftueshme per femijet jetime apo ata me probleme sociale dhe ekonomike, apo per femijet me nevoja te vecanta.

Per femijet e familjeve te varfëra ne Shqipëri eshte e zakonshme qe te punojne sidomos ne tregun informal duke shitur cigare, lare makina apo duke lypur. Per shkak te normes se larte te varferise tek femijet rome dhe ata egjiptiane, nje pjese e madhe e femijeve qe punojne vijne nga keto grupe. Nje vezhgim i bere nga ILO dhe Instituti per Studime Bashkekohore ka gjetur se 40 perqind e familjeve Rome dhe 43 perqind e familjeve Egjiptiane u kerkojne femijeve te punojne dhe per kete arsye femijet nuk shkojne ne shkolle. Pothuaj gjysma e femijeve qe punojne ne rruge vijne nga familje qe kane migruar nga qytete te tjera gjate tranzicionit.

Nga viti 2001, ka te dhena perfshi dhe ato nga Strategjia Kombetare Kunder Trafikimit te Njerezve qe rreth 4,000 femije shqiptare kane emigruar ne vendet fqinje pa prindet e tyre dhe jane te rrezikuar ndaj puneve te veshtira , lypjes dhe forma te tjera te shfrytezimit.

Ndaj familjeve me raste te qarta te neglizhences ndaj femijeve, abuzimit apo rrahjes nuk ushtrohet asnje lloj kontrolli per mbrojtjen e te drejtave te femijeve dhe forcimin e pergjegjesisë prinderore. Per prinderit qe braktisin femijet e tyre ose qe nuk i dergojne ata ne shkolle, nuk merret asnje mase.

Detyra e politikës: Zhvillimi i nje politike te integruar dhe i nje strukture institucionale per te siguruar nderhyrje te hershme per femijet e rrezikuar, per zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre nga te gjitha llojet e abuzimit, dhunes dhe shfrytezimit.

Masat

Strategjia Kombetare e Femijeve dhe plani i veprimit (2005-2010)³², publikuar ne fund te vitit 2005, mbulon te gjitha aspektet e jetes se femijes dhe perfshin veprimtari ne lidhje me varferine e femijeve. Ne vitin 2004 u ngrit Komiteti Nderministror per te Drejtat e Femijeve dhe ne vitin 2006 Sekretariati Teknik prane Ministrine e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta eshte pergjegjes per mbikqyrjen e strategjise dhe te planit te veprimit.

Shqiperia po kalon nje reforme ne te cilen shërbimet per femijet do te kalojne nga institucionet ne familje, ne komunitet dhe ne familjen sociale. Ne situaten aktuale, institucionet qe ofrojne shërbimet dhe vete shërbimet, kane kaluar nga pergjegjesia e pushtetit qendror ne ate te pushtetit lokal. Strategjia e Mbrojtjes Sociale ka marre masa te cilat do te ndikojne pozitivisht dhe drejtperdrejte ne rritjen dhe zhvillimin e femijeve nga komuniteti Rom , si dhe femijeve me aftesi te kufizuar.

Ceshtjet penale per te miturit ashtu si dhe per te rriturit trajtohen nga seksionet penale te gjykatave te retheve. Jane ngritur dhe do te vazhdojne te ngrihen seksione per te miturit ne

³¹ UNICEF Gjendja e Femijeve ne Shqipëri 2006 Te Perjashtuar dhe Te Padukshem

³² Te perfshihet si pjese e Strategjise se Mbrojtjes Sociale (pezull)

paraburgim. Ka filluar te behet kujdes i vecante per ndarjen e minoreneve nga te rriturit (burgu i Vaqarrit), duke krijuar kushtet qe ata te ndjekin shkollen, te perdorin biblioteken, te meren me aktivitete sportive dhe kulturore dhe te praktikojne besimin e tyre fetar. Persa i perket sistemit te punonjesve social dhe psikologe, qe veprojne ne sistemin e drejtesise per femijet ne konflikt me ligjin, eshte i dobet dhe jo i organizuar. Prandaj, ngritja dhe venia ne funksionim i sherbimeve psiko-sociale te licensuara ne sistemin e drejtesise per te miturit ne konflikt me ligjin, tashme eshte ne proces.

Hapa te ardhshme perfshijne:

- Strukturat e duhura organizative dhe sherbime te targetuara, ofruar nga gjykatat dhe sherbimet e riedukimit. Ketu perfshihen seksione te vecanta ne gjykata, ngritja e Institutit te Riedukimit te Minoreneve dhe sigurimi i sherbimeve te rehabilitimit.
- Procedura te permiresuara per trajtimin e minoreneve sidomos per kodin penal, civil dhe kodin e familjes.
- Hartimin e nje kodi per femijet.
- Zbatimi i legjislacionit per nxitjen e te drejtave te femijeve dhe mbrojtjen e femijes nga rreziku per jeten, shendetin, arsimimin dhe zhvillimin normal.

Ne vitin 2005 u miratua Strategjia Kombetare per Personat me Aftesi te Kufizuar. Megjithese strategjia e konsideron paaftesine nga nje kendveshtrim i pergjithshem dhe jo domosdoshmerisht nga pikepamja e femijeve, ajo vendos theksin ne marrjen e masave per parandalimin e paaftesise qe nga femijeria. Ajo parashikon dhe masa per integrimin dhe rehabilitimin e femijes duke krijuar kushte qe ata te shkojne ne shkolle, te marrin pjese ne jeten sociale dhe te pergatiten per sfidat e se ardhmes.

Problemi i punes se femijeve tashme eshte problem kyc per qeverine shqiptare. Ajo ka ratifikuar Konventen Nderkombetare te Zyres se Punes (ILO) No. 138 "Ne lidhje me moshen minimale per pune" si dhe Konventen No.182 "Mbi format me te ashpra te punes se femijeve". Ne perputhje me standartet e ILO, qeveria ka futur ne fuqi legjislacionin per parandalimin e punes se femijeve dhe per vendosjen e kufijve per pranimin ne pune te femijeve. Kodi i ri i Punes njeh si moshe pune per femijet moshen 16 vjecare dhe siguron mbrojtje te vecante per femijet qe punojne, duke harmonizuar legjislacionin vendas me konventat e ratifikuara. Si instrument Shqiperia ka ratifikuar dhe Kartën Sociale Evropiane qe ndalon punen e femijeve nen 15 vjec. Ne Planin Kombetar per Punen e Femijeve jane marre masa per t'a perforcuar arsimin e detyrueshem dhe per te krijuar mundesi per formimin profesional.

Strategjia Ndersektoriale "Kunder Krimit te Organizuar dhe Trafikimit" permban masa per mbrojtjen e femijeve te rrezikuar ne keto fusha.

Reformat ne sektorin e shendetsise dhe arsimit do te rritin aksesin e femijeve tek sherbimet cilesore. Sipas Objektivave te Zhvillimit te Mijevjecarit, sektori i shendetsise ka vene objektivin e uljes se vdekshmerise ne 10 vdekje per 1,000 lindje per femijet ne moshen 5 vjec deri ne fund te vitit 2015. Kjo do te arrihet nepermjet menaxhimit te integruar te pacientit ku perfshihet ekzaminimi, trajtimi dhe keshillimi per semundjet e femijerise si dhe permiresimi i te ushqyerit te femijes dhe nenes.

Ne sektorin e arsimit do te sigurohet akses ne arsimin parashkollor per te gjithë femijet e moshes 5-6 vjecare deri ne vitin 2015 dhe per shumicen e femijve te moshes 3 deri ne 5 vjecare. Per periudhen afat-shkurter nje gje e tille do te arrihet duke perdorur modelet komunitare qe zbatohen nga OJF-te. Nje objektiv tjeter eshte ngritja e institucioneve multiprofesionale ne njesite e pushtetit lokal, te cilat do te meren me problemet e ndryshme qe pengojne integrimin, dhe zhvillimin e barazine tek femijet. Reduktimi i analfabetizmit

ndermjet femijeve qe braktisin shkollen nepermjet programeve te vecanta p.sh. Programi "Shansi i Dyle".

Synime

- Te gjithë femijet e moshes 5-6 vjecare do te kene akses ne arsimin parashkollor deri ne vitin 2015
- Vdekshmeria e femijeve nen pese vjec do te reduktohet ne 10 vdekje per 1,000 lindje deri ne vitin 2015.

Romet

Situata

Pikepyetjet per problemet etnike jane pranuar qe me censusin e vitit 2001 por vleresuesit kane dale me nje numer nga 90,000 deri 100,000 nga nje popullsi prej 3.3 million.³³ Shumica e Romeve ne Shqiperi jetojne nen nivelin e varferise. Niveli i varferise qe u perdor eshte PPP \$4.30 ne dite dhe per ata qe jane ekstremisht te varfer ky nivel eshte PPP \$2.15.³⁴ Norma e varferise te Romeve ne Shqiperi eshte 78 perqind ne krahasim me shumicen qe ne kohen e studimit ishte³⁵ 22 perqind (2005). Varferia e tejskajshme per Romet e Shqiperise eshte shume e larte, 39 perqind. Shpenzimi mesatar eshte 555 euro ne muaj per Romet ne krahasim me 875 per shumicen e shqiptareve.³⁶

Diskriminimi, mungesa e te ardhurave te rregullta dhe e punesimit, kombinuar me familje me shume anetare sjell frekuentimin e ulet te shkolles, shendet jo te mire, borxhe, dhe shtepi te varfera ose mungese shtepish. Menyra e jeteses dhe varferia ndikojne ne arsimimin e femijve dhe aksesin tek sherbimet.

Perqindja e papunesise, megjithese eshte e veshtire te matet, eshte shume e larte per Romet, ku grate kane perqindjen me te larte te papunesise sesa burrat, 60 perqind ne krahasim e 33 perqind (vezhgim i PNUD, 2004). Te dhenat nga studimi i PNUD mbeshtetin pikepamjen qe Romet kane tendence te perfshihen me shume ne punesimin informal dhe punet e pakualifikuara. Ne Shqiperi, 79 perqind e Romeve jane punesuar ne sektorin informal krahasuar me 22 perqind te shumices se popullsise. Nje nga pasojat per Romet eshte mungesa e pjesemarrjes ne skemat e sigurimeve shoqerore dhe per rrjedhoje nuk perfitojne pension pleqerie.³⁷

Studimi i PNUD (2004) gjeti qe femijet Rome shpenzojne mesatarisht me pak se gjysmen e kohes se femijve te shumices se popullsise ne sistemin arsimor. Per rrjedhoje, nje ne kater Rome jane te pa arsimuar. Grate Rome (ne rajon) jane shume vulnerabel. Tre te katertat e grave Rome nuk e mbarojne arsimin fillor (krahasuar me nje ne pese gra nga shumica) dhe pothuaj nje e treta jane te paarsimuara (krahasuar me 1 ne 20 gra nga shumica). Vajzat Rome vuajne nga mungesa e arsimit me nje perqindje shume te ulet dhe frekuentim te ulet

³³ Liègeois, 2006

³⁴ Kufiri i varferise dhe varferise ekstreme (PPP \$4.30 dhe PPP \$2.15 ne dite shpenzime) bazohet ne kufijte sipas konceptit te Bankes Boterore 2005a. Por edhe raporti i PNUD merr ne konsiderate nje mase shpenzimi te ekuivalentuar dhe jo per fryme, sipas llogaritjeve te OECD.

³⁵ Termi 'shumica' eshte perdorur duke iu referuar 'modelit majority-in-proximity' (komunitete qe nuk jane Rome por qe jetojne afer tyre) i cili u pershtat nga vezhgimi i PNUD ne ngritjen e grupeve te kontrollit. Ky u zgjodh nga nje 'model perfaqesues ne shkalle kombetare' per shkaqe te thena ne raportin Roma and Displaced in South East Europe, UNDP 2006

³⁶ At Risk: Roma and the Displaced in South East Europe, UNDP, 2006

³⁷ At Risk: Roma and the Displaced in South East Europe, UNDP, 2006

Rreth 20 përqind e femijeve Rome (deri në moshën 14 vjeç) nuk janë vaksinuar në krahasim me rreth 3 përqind të shumicës. Shkaku për mungesën e vaksinimit të plotë, shpesh është informacioni i pamjaftueshëm apo identifikimi mjekësor.³⁸

Diferencat në të ushqyerit e sigurt në rajon janë me të dukshme sesa ndryshimet në situatën shëndetësore. Shpenzimet e familjeve Rome për ushqim janë me të pakta sesa ato të shumicës së familjeve.³⁹

Studimi për Vlerësimin e Vulnerabilitetit: Rome në Shqipëri, PNUD, 2005 gjeti se 65 përqind e Romeve jetojnë në baraka. Ndryshimet e shpeshta të vendbanimit, martesat e hershme, mosnjohja e ligjit kanë bërë që Rome të mos jenë të regjistruar. Për këtë shkak ata nuk mund të aplikojnë për asistencë të cilën kanë të drejtë të marrin sipas ligjit shqiptar.

Detyra e politikës : Bashkëpunimi i qeverisë me Rome për përmirësimin e statusit të komunitetit Rom në Shqipëri nëpërmjet institucionalizimit të politikave dhe programeve për reduktimin e varfërisë, mposhtjen e diskriminimit dhe sigurimin e integritetit .

Masat

Shqipëria është pjesë e instrumentave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoriteteve. Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom në Shqipëri (2005) është një strategji multidimensionale që synon të çlirojë Rome nga varfëria dhe përjashtimi social.⁴⁰ Qeveria dhe Rome do të punojnë në partneritet për zbatimin e strategjisë. Në Drejtorinë e Shërbimit Social Shtetëror pranë MPCSSHB funksionon një Sekretariat për Rome për të nxitur dhe monitoruar zbatimin e strategjisë. Qeveria është angazhuar të marrë masa për të luftuar stereotipet, paragjykimet dhe praktikat diskriminuese. Fusha të rëndësishme për këtë strategji janë:

- Regjistrimi i Romeve për të bërë të mundur mbrojtjen e të drejtave dhe aksesin tek shërbimet.
- Sigurimi i arsimimit, përfshi aksesin në arsimin parashkollor, motivuesit për frekuentimin e shkollës fillore, mbështetjen për femijet të mesojnë gjuhën shqip, sigurimin e mesuesve që flasin gjuhën romë dhe programet e arsimimit të të rriturve.
- Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe e familjes ku përfshihet edhe ruajtja e traditave dhe fuqizimi i grave.
- Rritja e punësimit nëpërmjet subvencionimit të punëdhënësve dhe aksesit në formimin profesional. Duhet bashkëpunim mes Shërbimit Social Shtetëror dhe pushtetit lokal për zbatimin e programeve të trajnimit të subvencionuara dhe të projekteve të punëve publike që inkurajojnë pjesëmarrjen në tregun e punës nga të papunët të parregjistruar Rome.
- Përfitim nga masat e marra për formalizimin e punës informale.
- Mbrojtja sociale, akses tek përfitimet përfshi NE dhe pagesën e papunësisë.
- Mbulimi i shërbimeve shëndetësore në komunitetet Rome dhe nxitja e planifikimit familjar, imunizimi dhe kujdesi para dhe pas lindjes së femijes. Për vlerësimin e rasteve të sëmundshmerisë dhe përqindjes së vdekshmërisë në komunitetet Rome janë planifikuar studime dhe identifikuar masa për reduktimin dhe kontrollin e tyre.
- Përmirësimi i kushteve të jetesës përfshi banesat, të drejtat mbi pronën, rrugët dhe sigurimin e shërbimeve baze (uji, higjiena, korrenti dhe telekomunikacioni) në zonat e Romeve.
- Masa për përmirësimin e aksesit në drejtësi dhe rendin publik nëpërmjet rekrutimit të Romeve si police dhe parandalimit të trafikimit.

³⁸ At Risk: Roma and the Displaced in South East Europe, UNDP, 2006

³⁹ At Risk: Roma and the Displaced in South East Europe, UNDP, 2006

⁴⁰ Pranuar nga VKM No. 633/2003 dhe do integrohet në Strategjinë e Mbrojtjes Sociale (pezull)

Politikat e synuara ne strategjine e re te punesimit per punesimin dhe formimin profesional te femijeve do t'i ndihmojne shume femijet Rome qe jane ne disavantazh ne kete situatë. Strategjia Kombetare synon te siguroje sherbime keshillimi per ngritjen e bizneseve, vëzhgimin e tregut dhe aksesin ne kredi per komunitetet Rome qe te ngrene bizneset e tyre.

Prioritet do ti jepet trajtimit te komunitetit Rom nepermjet programeve te vecanta per arsimim, ne menyre qe te kapercejne pasojat e diskriminimit te tyre afat-gjate. Gjithashtu do te kete prioritet perfshirja e komunitetit Rom ne evenimentet kulturore e artistike duke bere te mundur integrimin kulturor te tyre ne vend.

Per permiresimin e strehimit, ne buxhetin e viteve 2006/07 u alokuan fonde per banesa te vecanta per Romet. Jane bere perpjekjet per: (i) identifikimin e familjeve qe kane nevoje per strehim, madhesine e ketyre familjeve dhe kushtet aktuale te banimit dhe do te pasohen nga (ii) identifikimi i banesave qe kane nevoje per rehabilitim dhe riparim (iii) pergatitja dhe kostimi i punes rehabilituese; (iii) identifikimi i se drejtes mbi pronen ne te cilen Romet kane ndertuar shtepite e tyre; (iv) vleresimi i nevojave per toke dhe material ndertimi dhe llogaritja e fatures; (v) inkurajimi i komunitetit Rom per te kontribuar me pune per ndertim dhe riparim; dhe (vi) ndertimi i shtepive modeste te lira per te pastrehet dhe familjet qe jetojne ne kushtet me te keqia.

Synimet

- Rritja e perqindjes se punesimit te grave rome.
- Rritja e shkalles se arsimimit te femijeve rom i cili ka impakte ne parandalimin e perjashtimit social.
- Ofrimi i trainimit profesional pa pagese.

Ballkano-Egjyptianet

Ne kuadrin e identifikimit te minoriteve dhe grupeve etnike, nje tjeter grup etnik i identifikuar eshte ai i ballkano – egjyptianeve. Eshte nje grup qe ka shume probleme ekonomike dhe sociale, por per shkak te specifikes antropologjike, riteve, zakoneve, mentalitetit dhe menyres se jeteses te ndryshme nga grupet e tjera, kerkon formulimin e politikave sociale specifike.

Shoqata "Nefreta" eshte nje OJF shume aktive qe mbron interesat e ketij grupi etnik. Aktualisht ky grup eshte i perfshire ne Programin e Qeverise por duke qene se deri tani nuk ka nje dokument te vecante politik ku te trajtohen problemet dhe politikat qe duhet te ndermarre qeveria ne mbeshtetje te ketij grupi , sugjerohet hartimi i nje Strategjie te vecante per kete komunitet.

Personat me Aftesi te Kufizuar (PAK)

Situata

Mbledhja e statistikave per personat me aftesi te kufizuar eshte kufizuar tek ata qe marrin pagesen e aftesise se kufizuar dhe ata qe marrin sherbime ne qendrat publike rezidenciale apo ditore. Statistikat nuk ndahen sipas gjinise dhe ka pak informacion mbi nivelin e punesimit te personave me aftesi te kufizuar. Gjate vitit 2007 filluan perpjekjet per mbledhjen e informacionit lidhur me papunesine e personave me aftesi te kufizuar te cilet munden dhe deshirojne te punojne.

Neni 25 i Kushtetutes se Shqiperise garanton te drejtat dhe lirite themelore per PAK. Kuadri ligjor per permiresimin e statusit ekonomik dhe social, qe ka per qellim te garantoje shanse te barabarta per PAK ne shoqerine shqiptare po permiresohet gradualisht. Ka patur nje rritje te shpejte te numrit te perfittuesve ne keto vitet e fundit (nga 43,100 ne 2000 ne 62142 ne 2006), ku shpenzimet reale nga viti 2000 ne vitin 2006 pothuaj jane dyfishuar. Pagesa per aftesine e kufizuar eshte 50 perqind e pages minimale. Aktualisht pagesa eshte 8.000 leke ne muaj per person. Pagesa per aftesine e kufizuar filloi ne vitin 1993 dhe qe at'here ka synuar personat e certifikuar me aftesi te kufizuar para moshes 21 vjecare (24 nese ndjek universitetin). Por qe nga viti 2005 ligji ka ndryshuar duke perfshire persona te cilet jane bere te paaftë ne femijeri si rezultat i demtimeve apo semundjeve qe nuk lidhen me punen, edhe percaktimi i paaftesise ka ndryshuar ne pershtatje me standartet nderkombetare.

Pagesat per Te Verberit, Paraplegjiket dhe Tetraplegjiket perfshijne; pagesat mujore ne cash per PAK dhe nje pagese plus per kujdestaret; perjashtimin nga taksa e drejtperdrejte; karburantin falas per mjetet e tyre motorike; subvencionin per energji; rimbursimin per ilacet; transportin falas dhe 50 perqind per transportin nderurban. Personat me aftesi te kufizuara mendore e fizike perfitojne nje pagese mujore ne cash dhe nje pagese plus per kujdestaret nese jane te nevojshem. Pagesat per Invalidet e Punes (per ata qe jane demtuar ne pune dhe qe kontribuojne per sigurimet shoqerore) perfshijne pensionet e invalideve nga Instituti Sigurimeve Shoqerore; perjashtimin nga taksat e drejtperdrejte; karburantin falas per mjetet e tyre motorike; subvencionin per energji; rimbursimin per ilacet; transportin publik falas dhe 50 perqind per transportin nderurban si dhe pagesen e NE per familjet e tyre nese plotesojne kriterin e perfittimit.

Ndersa jane ritur pagesat nga shteti per personat me aftesi te kufizuar, nuk eshte perpunuar akoma nje metode e integruar dhe e qendrueshme per rehabilitimin e tyre. Kodi i Punes ndalon cdo lloj diskriminimi ne punesim dhe trajnim profesional te PAK. Legjislacioni nga mesi i viteve 1990 specifikon qe nje punedhenes me 25 punonjes duhet te kete nje te person me aftesi te kufizuara qe eshte ne gjendje te punoje ose ndryshe duhet te paguaje gjobe tek Fondi Kombetar i Punesimit⁴¹. Fatkeqesisht ky ligj nuk po zbatohet mire. Sidoqofte jane planifikuar permiresime. Trajnimi profesional ofrohet falas per PAK qe regjistrohen ne kurse publike dhe po kesaj kategorie i jepet rimbursim per te ndjekur kurse private.⁴²

Shteti jep disa fonde per OJF-te e drejtura nga PAK per prodhimin e karrocave te invalideve.

Vleresohen rreth 12,000 femije me aftesi te kufizuara . Femijet me nevoja te vecanta ose jane integruar ose jane vendosur ne klasa te vecanta. Qendrat ditore dhe shkollat e specializuara ofrojne sherbime per 1140 femije. Keto shkolla u sherbejne 80-90% te femijeve me mangesi ne degjim dhe shikim.

Detyra e politikës: Integrimi i politikave dhe masave qe nxitin perfshirjen e plote te personave me aftesi te kufizuara ne te gjithë fushat e jetes se perditshme.

Masat

Strategjia Kombetare per PAK (2005-2014) dhe plani i veprimit eshte ne perputhje me udhezimet nderkombetare te Kombeve te Bashkuara, Keshillit te Europes dhe Bashkimit Europian.⁴³ Strategjia ve theksin ne masat per permiresimin e kushteve te jeteses se personave me aftesi te kufizuara ne fushen e arsimit, punesimit, sherbimeve mbeshtetese

⁴¹ Strategjia Kombetare e PAK. Punedhenesi mund te punesoje nje person me aftesi te kufizuara ne gjendje te rende nga pese PAK ne gjendje me te lehte .

⁴² Ligji No. 8872 "Mbi Arsimin dhe Formimin Profesional ne Republiken e Shqiperise", date 29.03.2002

⁴³ Sipas VKM 8/2005 per t'u integruar tek Strategjia e Mbrojtjes Sociale (pezull)

dhe aksesit, duke u përqendruar me shume tek aftësitë dhe kompetencat e individit sesa tek paaftësia e tij.

Shtatë objektivat kryesore të strategjisë janë:

1. Inkurajimi dhe edukimi për një shoqëri pa paaftësi
2. Sigurimi i të drejtave për PAK
3. Sigurimi i arsimimit me të mirë për PAK
4. Sigurimi i shanseve për punësim dhe zhvillim ekonomik për PAK
5. Nxjtja dhe ndergjegjësimi i shërbimeve publike përgjegjëse
6. Mbeshtetja për një jetë cilësore në komunitet për PAK
7. Mbledhja dhe përdorimi i informacionit prekës për PAK dhe problemet e paaftësisë.

Strategjia është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave në 1 Korrik 2005 dhe janë përcaktuar prioritetet imediate dhe kuadri monitorues dhe vlerësues. Për mbikqyrjen e zbatimit të strategjisë është ngritur një komitet nderministror dhe Sekretariati në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për të mbështetur komitetin dhe për të vëzhguar objektivat e miratuara për ministritë e tjera.

Aktualisht janë miratuar Standartet e Shërbimeve për Personat me Aftësi të Kufizuar, që kanë për qëllim të sigurojnë standartet minimale për shërbimet e ofruara për PAK.

Nga viti 2007, statistikat për ata që përfitojnë pagesën e paaftësisë do të ndahen sipas llojit të paaftësisë, mases së pagesës, grup-moshës dhe gjinisë.

Synimi

- Pagesa baze e PAK do të indeksohet çdo vit me rritjen e pages minimale në shkallë vendi.
- Kalimi i të gjithë institucioneve rezidenciale të PAK në varesi të qeverisjes vendore deri në fund 2008. Ngritja dhe venia në funksionin e 9 shërbimeve komunitare ditore për PAK në njësi të ndryshme të qeverisjes vendore.

Te Moshuarit

Situata

Megjithatë Shqipëria ka popullsinë më të re në Europë, përqindja e popullsisë mbi moshën 60 vjeç është në rritje graduale. Parashikohet që ajo të përbejë 12.2 përqind të popullsisë deri në vitin 2010 nga 10.4 përqind në vitin 2000. Të dhënat e fundit nga INSTAT për vitin 2005 tregojnë se afër 37,000 njerez mbi moshën 66 vjeç jetojnë nën kufirin e varferisë. Megjithatë është shumë më pak se viti 2002 (një ulje prej 31 përqind) përse nuk është e pranueshme dhe kujdesi për të moshuarit që keta të kenë mundësi të plotësojnë nevojat e tyre dhe të përmirësojnë cilësinë e jetës, përben një nga prioritetet e politikave sociale.

Megjithatë mungesa e të dhënave mbi shëndetin, mirëqenien dhe përkrahjen sociale për të moshuarit, niveli i lartë i sëmundjeve kronike, barra e paaftësisë tërësisht e menjanueshme, deprivimi ekonomik dhe mungesa e oportuniteteve sociale, nënkuptojnë që shumica e njerezve në moshë, më shumë përpigën të mbijetojnë sesa të jetojnë kënaqësitë e oportuniteteve sociale dhe personale. Në këtë mënyrë vetë shoqëria është e privuar nga kontributi që mund të përfitonte nga eksperiencia e qytetarëve të saj më të moshuar, dhe për më tepër paguan një çmim për kujdesin social dhe shëndetsor.

Per te moshuarit ka pak qendra rezidenciale (pese jane te financuara nga shteti) dhe asnje spital me trajtim afat-gjate. Per shumicen e te moshuarve kujdesen te afermit. Rreziku i varferise dhe perjashtimit social eshte me i larte per te moshuarit qe jetojne vetem.

Te gjithë qytetaret qe kane punuar dhe kane paguar kontributet, perfitojne pension pleqerie dhe ne rastet kur ata nuk kane ndonje te ardhur, mbeshteten nga Ndihma Ekonomike. Te ulta sipas standarteve rajonale, pensionet ne qytete jane te barabarta me me shume se nje te terten e konsumit familjar te familjeve me te varfera ndersa pensionet ne fshat jane barabar me 20 perqind te konsumit te familjeve me te varfera fshatare.⁴⁴ Sistemi i pensioneve me normen e larte te kontributeve dhe pagesen e ulet, nuk eshte i qendrueshem dhe ka nevojë per reformim.

Detyra e politikës: Lehtesimi i veshtiresive ekonomike dhe deprivimit social per te moshuarit dhe krijimi i mundesive per te bere nje jete me dinjitoze, per te jetuar me gjate dhe per te qene te shendetshem gjate pleqerise se tyre.

Masat

Me decentralizimin dhe deinstitucionalizimin e sherbimeve sociale tek pushteti lokal, pritet qe te zhvillohen per te moshuarit sherbimet e reja me baze komunitare perfshi ketu edhe sherbimet mbeshtetese brenda familjes dhe qendrave komunitare. Jane percaktuar standarte per kujdesin per te moshuarit ne perputhje me standartet nderkombetare.

Mbeshtetja ekonomike dhe aksesimi tek sherbimet jane te rendesishme per permiresimin e cilesise se jetes te te moshuarve. Jane ndermarre masa per ritjen ne nje mase me te madhe te pensioneve te uleta dhe vecanerisht ato te fshatit, me objektiv dyfishimin e tyre deri ne vitin 2009 dhe duke ngushtuar diferencen ndermjet pensioneve ne qytet dhe ne fshat. Aktualisht eshte duke u rishikuar sistemi i pensioneve, per te siguruar qendrueshmeri ne te ardhmen.

Synimi

- Deri ne vitin 2009, do te kete dyfishim te pensioneve dhe nuk do te kete pensione nen kufirin kombetar te varferise

Te rinjte ne nevojë

Situata

Me popullaten më të re në Europë, ky është edhe një nga grupet sociale të rezikuara nga përjashtimi social. Si fenomene që mund të prekin grupin e të rinjve të rezikuar përmendim rrezikun nga HIV/AIDS, dhuna ndaj të rinjve, abuzimi me drogë, alkoolin e duhanin, trafikimin e vajzave të reja etj.

Detyra e Politikës : Lehtesimi i veshtiresive ekonomike dhe përjashtimit social per te rinjtë dhe krijimi i mundesive per te bere nje jete me te shendetshme, larg krimit, drogës, alkoolit, e fenomeneve të tjera negative të shoqërisë.

Masat qe do te ndermerren nga qeveria ne vitet e ardhshme jane te pasqyruara gjeresisht ne Strategjine Ndersektoriale per Rinine.

⁴⁴ World Bank PEIR, 2006

Grate

Situata

Kodi i punes i vitit 1995 dhe Ligji per Barazine Gjinore ne Shqiperi i vitit 2004, sigurojne trajtim te barabarte per burrat dhe grate. Sidoqofte, grate perbejne nje nga grupet qe kane vuajtur pasojat e tranzicionit social, emigracionit dhe papunesise. Pensionet e vogla te cilat bazohen ne vitet e punes nenkuptojne qe shume gra te jane ne rrezik varferimi dhe perjashtimi social kur te plaken. Grate gjenden shume shpesh ne situata delikate sepse kane pergjegjesine kryesore te perkujdesjes per femijet dhe anetaret e tjere te familjes, ato paguhen shume me pak se burrat dhe kane me pak mundesi per te siguruar pune.⁴⁵ Politikat per zbutjen e nje situate te tille lidhen sidomos me punesimin dhe mbeshtetjen per grate si kryefamiljare, grate e trafikuar apo qe jane ne rrezik trafikimi, ato me te cilat eshte abuzuar dhe grate nga komuniteti minoritar.⁴⁶

Detyra e politikës : Sigurimi i te ardhurave te barabarta si per grate dhe per burrat nepermjet kombinimit te masave te synuara dhe te orientuara mire, sic jane rritja e stabilitetit ekonomik, pjesemarrja ne vendim marje dhe akses ne drejtesi.

Masat

Qeveria eshte angazhuar per permiresimin e barazise gjinore si aspekt i rendesishem i zhvillimit te vendit dhe ne vecanti i zonave rurale dhe atyre te pazhvilluara. Drejtoria e Shanseve te Barabarta ne Ministrine e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta⁴⁷, u krijua per te formuluar politika dhe masa te synuara mire ne fushen gjinore, ate te minoriteteve etnike (si kulturore dhe gjuhesore), te personave me aftesi te kufizuara, te diskriminimit ne baze race apo moshe. Prioritet i jepet inkurajimit te barazise gjinore dhe pjesemarrjes me te gjere te grave ne jeten ekonomike, politike dhe sociale te vendit.

Funksionet e drejtorise se re perfshijne:

- Koordinimin e analizave dhe studimeve mbi ceshtje qe lidhen me shanset e barabarta
- Formulimin e ligjeve dhe rregullave per sigurimin e barazise ne te gjitha institucionet shteterore
- Monitorimin e legjislacionit dhe rregulloreve qe adresojne ceshtje te barazise ne institucionet shteterore
- Mbikqyrjen e zbatimit te marreveshjeve nderkombetare nenshkruar nga Qeveria Shqiptare ne lidhje me barazine
- Koordinimin e programeve te ndergjegjesimit per problemet e barazise

Drejtoria po supervizon rishikimin e Ligjit te Barazise Gjinore ne Shoqeri te vitit 2004 me synimin per te lehtesuar zbatimin, per te mos lejuar diskriminimin midis grave dhe burrave .

Dhuna ne familje

Situata

Kushtetuta e Shqiperise dhe kuadri ligjor siguron te drejta te barabarta dhe mbrojtje per te gjitha qytetaret. Sidoqofte, problemet e dhunes ne familje, abuzimi fizik, seksual, psikologjik

⁴⁵ Shih Pjesemarrjen e grave ne tregun e punes

⁴⁶ Pjesemarrja e grave ne tregun e punes, viktimat e dhunes ne familje dhe iniciativat e grate Rome jane perfshire ne nje seksion tjetër te kesaj strategjie. Strategjia ndersektoriale kunder Krimin te Organizuar dhe Anti Trafikimit paraqet politika per grate dhe femijet, viktimat e trafikimit.

⁴⁷ Mbas ndryshimeve ne ligjin no. 9198, "Mbi Barazine Gjinore ne Shoqeri" data 1.7. 2004

dhe ekonomik i ushtruar nga partneri me i afert dhe anetare te tjere te familjes, akoma nuk njihen plotesisht nga shoqeria shqiptare. Studimet e pakta qe jane bere tregojne se dhuna ne familje i kalon kufijte social-ekonomik dhe nuk raportohet, nuk ka te dhena statistikore per te ne rang kombetar dhe ka mungese sherbimesh per viktimat, duke marre ne konsiderate edhe aksesin e paket ne drejtesi.

Ligji nuk i detyron forcat e policise, zyrtat e avokatise, qendrat shendetsore apo sherbimet sociale te mbledhin te dhena dhe te raportojne per dhunen ne familje.⁴⁸ Strategjia e Mbrojtjes Sociale ve ne dukje mungesen e:

- Ndergjegjesimit per rolin e grave ne familje
- Sherbimeve te keshillimit dhe rehabilitimit per viktimat
- Specialisteve, sociologeve, psikologeve, juristeve dhe mjekeve qe do te meren me problemet e dhunes ne familje.

Legjislacioni aktual permban masa per mbrojtjen e grave nga dhuna ne familje por keto masa kane gjetur pak aplikim ne praktiken e gjykatave.⁴⁹ Inisiativat e ndemarra nga qeveria jane: Miratimi i Ligjit Nr 9669 date 18.12.2006 "Per masat ndaj dhunes ne marredheniet familjare", aktet nenligjore te ketij ligji , te cilat tashme jane hartuar dhe jane ne fazen e miratimit, ngritja e strukturave pergjegjese per zbatimin e ligjit dhe hartimi i Strategjise se Barazise Gjinore dhe Dhunes ne Familje.

Detyra e politikës: Njohja e dhunes ne familje si krim qe kryhet kryesisht ndaj grave dhe formulimi i masave qe synojne parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave.

Masat

Politika dhe masat e efektshme per parandalimin e dhunes ne familje jane prioritare. Drejtimi kryesor aktualisht eshte ne ngritjen e strukturave pergjegjese per zbatimin e ligjit "Per masat ndaj dhunes ne marredheniet familjare", per te luftuar dhunen ndaj grave dhe per te mbrojtur viktimat. Zbatimi i Strategjise Kombetare te Barazise Gjinore dhe Dhunes ne Familje 2007-2010 dhe Plani i Veprimit do te beje te mundur:

- Mbledhjen e te dhenave per dhunen ne familje ne nivel kombetar, raportimin e krimit.
- Bashkepunimin ndermjet institucioneve dhe menaxhimit e rasteve nga policia
- Shtimin e sherbimeve per grate e dhunuara.
- Permiresimin e metejshem te kuadrit ligjor per mbrojtjen e grave.
- Mbeshtetjen e qeverise per sherbimet ndaj viktimave nepermjet OJF-ve.

Synimi

Rritja e ndergjegjesimit ndaj dukurise se dhunes , mbrojtje ligjore dhe administrative si dhe mbeshtetje per individete te prekur nga dhuna ne familje.

⁴⁸ Nga studimi per Shendetin riprodhues, Raporti perfundimtar 2005, cituar tek Dhuna ne Familje, Prezantim i Situates Aktuale ne Shqiperi, 2006.

⁴⁹ Country Reports on Human Rights Practices, US Department of State, 2005

Kapitulli 4: Pergjegjshmeria, Monitorimi dhe Vleresimi

Ne menyre qe politikat e qeverise te pakesojne efektet e perjashtimit social duhen perpjekje te perbashketa nga te gjitha halikat e pushtetit dhe partneritet ne shkalle te gjere. Strategjite sektoriale kane mekanizmat e tyre te dhenies se llogarise, monitorimit dhe vleresimit. Disa nga keto strategji permbajne plane veprimi shume te rendesishme, me pjesemarrje nga te gjitha hallkat shtetore, si per shembull plani i veprimit per Romet, femijet dhe personat me aftesi te kufizuar. Secili prej tyre ka proceset e tij monitoruese te brendshme dhe te jashtme te pavarura nga agjensite nderkombetare.

Progresi afat-mesem dhe afat-gjate gjate zbatimit te strategjise ndersektoriale te perfshirjes sociale do te vleresohet mbi bazen e indikatoreve te monitorimit te dhene me poshte. Per te siguruar dhenien e llogarise dhe per te dhene informacion mbi zhvillimet ne fushen e perfshirjes sociale, do te botohet nje buletin. Buletini do te trajtojte zhvillimet ne fushen e perfshirjes sociale. Cdo informacion ne lidhje me progresin do te perfshihet ne buletin (shih me poshte tabelen e raportimit per indikatoret e monitorimit). Grupi Keshillues i Strategjise se Perfshirjes Sociale (me perfaqesues nga OJF) do te sherbeje ne te ardhmen si nje kanal komunikimi, per te dhene informacion per politikat e perfshirjes sociale per tu pasqyruar ne buletin.

Vleresimi i politikave eshte bere kryesisht nga donatoret dhe institucionet kerkimore. Gjithashtu Instituti i Statistikave mund te jape informacion cilesor nepermjet anketimeve te bera per vleresimin e politikave. Ne MPCSSHB ekziston nje Sektor per Monitorimin dhe Vleresimin e Politikave , i cili gjate vitit 2005 kreu nje studim lidhur me vleresimin e shperndarjes se bllokgranteve te NE. Gjithsesi per arsye te stafit te limituar dhe mungeses se kapaciteteve te duhura, kryerja e studimeve periodike nga ky sektor per vleresimin e politikave ka qene e veshtire. Kjo kerkon qe gjate vitit 2008 , MPCSSHB te rivleresoje fuqizimin e struktures se monitorim-vleresimit te politikave , qe do te sherbeje edhe per monitorimin dhe vleresimin e progresit te SPS dhe botimit te buletinit te siperpermendur. Kjo do te fokusojte pergjegjesine qe ka MPCSSHB per procesin e Perfshirjes Sociale , qofte persa i perket politikave te saj sociale ne funksion te reduktimit te varferise dhe mbeshtetejes se grupeve ne nevoje ashtu edhe si koordinator e ceshtjeve nderprerese me fushat qe mbulojne ministrite e tjera.

Indikatoret e monitorimit

Jane percaktuar dy lloje indikatoresh: indikatoret e BE (Laeken) dhe indikatoret specifike per Shqiperine.

1. **Indikatoret Laeken**, te cilet jane pershtatur nga Keshilli i Europes ne vitin 2001 per monitorimin e progresit per zhdukjen e varferise deri ne vitin 2010 dhe per te kuptuarit e perjashtimit social. Keta indikatore orientohen me shume drejt rezultatit sesa drejt mjeteve te perdorura per ta arritur ate. Ato perfshijne ato qe konsiderohen si faktoret kryesore qe cojne ne perjashtimin social. Ne kete prizem, eshte menduar te perdoren disa nga keta indikatore per te patur mundesi krahasimi me vendet e tjera Europiane dhe per te terhequr vemendjen ndaj studimeve statistikore te cilat do te bejne te mundur matjen e ketyre indikatoreve.

Por nuk ka kufizime te rendesishme. Indikatoret Laeken qe matin varferine, e bejne kete nepermjet krahasimit te te ardhurave. Kjo metode eshte e pershtatshme per ekonomi ku

tregu i punes eshte formal dhe raportimi per te ardhurat eshte i besueshem. Por, per Shqiperine ku pjesa me e madhe e popullsise eshte e punesuar ne tregun informal, nivelet e mireqenjes maten me mire nepermjet konsumit dhe rekomandohet qe kjo metode te perdoret ne te ardhmen. Megjithese kjo nenkupton qe indikatorët te mos jene shume te krahasueshem me ato te vendeve te BE, gjithsesi ato do te japin nje tablo me realiste te kushteve social-ekonomike.

Disa nga indikatorët Laeken jane lene menjane ose per shkak se instrumentet statistikore nuk do te jene gati per shtate vitet e ardhshme (te tilla si ato qe duhen per te matur persistencen e te ardhurave te pakta) ose per shkak se jane me pak te pershtatshme per Shqiperine (per shembull, kohezioni rajonal).

2. Se dyti, vendimi per futjen e indikatorëve Laeken beri qe edhe vendet anetare te BE te identifikonin dhe pershtatnin ata indikatorë qe do te vinin ne dukje vecorite ne fusha te ndryshme. Keto nuk eshte e nevojshme te harmonizohen ne nivelin e BE. Per shembull, indikatorët Laeken e konsiderojne varferine ne Europe si nje problem deprivimi relativ, me fjale te tjera ato fokusohen ne perqindjen e njerezve qe jetojne me me pak se 60% te mesatares se te ardhurave, pavaresisht nese mesatarja eshte e barabarte me 500 euro apo 5000 euro. Ne Shqiperi, paga mesatare eshte shume me e ulet se ne vendet anetare te BE dhe varferia absolute eshte ende nje problem themelor i politikës. Keshtu, seria e dyte e indikatorëve trajton **ceshtje me rendesi kombetare**. Ndermjet tyre, jane dhe indikatorët e OZHM-ve, te cilat Shqiperia eshte angazhuar ti plotesoje deri ne vitin 2015.

Tabela e meposhtme paraqet secilin indikator, bashke me percaktimin, burimin, vleren baze dhe vleren e synuar. Dy do te jene studimet baze per marrjen e informacionit:

- Studimi per Matjen e Standarteve te Jeteses (LSMS) eshte nje studim ne rang kombetar qe bazohet tek familja si njesi, i bere fillimisht ne vitin 2002, i perseritur ne vitin 2005, dhe sipas Programit Statistikor 5-vjecar te INSTAT – do te behet perseri ne vitin 2008
- Studimi i Krahut te Punes (LFS) eshte nje studim ne rang kombetar qe eshte kryer nga INSTAT per here te pare ne vitin 2007.

Indikatorët e tjere pritet te maten nepermjet te dhenave administrative. Por, eshte propozuar futja e dy indikatorëve qe do te matin aspekte kyc social-ekonomike te popullsise Rome. Deri tani, nuk ka ndonje burim informacioni te disponueshem per vleresimin e gjendjes se arsimit dhe shendetit per Romet. Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Mundesive te Barabarta do te punoje per te siguruar fonde qe do te bejne te mundur monitorimin e progresit ne kete fushe te politikës.

	Indikator	Kategorizimi	Burimi aktual	Burimi i ardhshëm	Vlera (Viti)
1.	Laeken 1A Shkalla e varfërisë relative Përqindja e individëve që jetojnë në familje ku konsumi ekuivalent total familjar është më pak se 60% e konsumit ekuivalent median kombëtar.	- Total (burra dhe gra) 0-17 (burra dhe gra)	LSMS	LSMS	
2.	Laeken 1B Shkalla e varfërisë relative sipas llojit të aktivitetit Përqindja e individëve në moshën 18+ që jetojnë në familje ku konsumi ekuivalent total familjar është më pak se 60% e konsumit ekuivalent median kombëtar.	- Te punësuar me pagë (burra dhe gra) - Te vetë-punësuar (burra dhe gra) - Te papunë (burra dhe gra) - Pensioniste (burra dhe gra) - Inaktive të tjera (burra dhe gra)	LSMS	LSMS	
3.	Laeken 1C Shkalla e varfërisë relative sipas llojit të familjes Përqindja e individëve që jetojnë në familje ku konsumi ekuivalent total familjar është më pak se 60% e konsumit ekuivalent median kombëtar.	Familje pa femije në varesi: - Me një person, 65 vjeç e lart - Dy të rritur, të paktën 1 person 65+ Familje me femije në varesi: - Me një prind, 1+ fëmijet - Dy të rritur, 2 fëmije	LSMS	LSMS	
4.	Laeken 13 Shkalla e varfërisë relative për transferime sociale në cash Përqindja e individëve që jetojnë në familje ku konsumi ekuivalent total familjar është më pak se 60% e konsumit ekuivalent median kombëtar Llogarit konsumin: 1. duke përjashtuar të gjitha pagesat në cash 2. duke përfshirë pensionet për pensionistët dhe të veçant por duke përjashtuar të gjitha pagesat e tjera në cash.	- Burra - Gra	LSMS	LSMS	
5.	Laeken 1E Linja e varfërisë relative 1. në euro 2. në lek	- Familje me një person - Familje me 2 të rritur, 2 fëmije	LSMS	LSMS	
6.	Laeken 2 Raporti i kuintilëve ekstreme Raporti i konsumit total të 20% të popullsisë së vendit me konsumin më të lartë (kuintili i sipërm) me atë të 20% të popullsisë së vendit me konsumin më të ulët (kuintili i poshtëm)		LSMS	LSMS	
7.	Laeken 4 Hendeku i varfërisë relative Diferenca ndërmjet konsumit ekuivalent median të personave nën linjen e varfërisë dhe veta kesaj linje, e shprehur si	- Burra - Gra	LSMS	LSMS	

	Indikator	Kategorizimi	Burimi aktual	Burimi i ardhshëm	Vlera (Viti)
8.	perqindje e kesaj linje. Perqendrimi rreth linjes se varferise Perqindja e personave me nje konsum nen: 1. 40% 2. 50% 3. 70% te medianit kombetar		LSMS	LSMS	
9.	Koeficienti Gini Matja e pabarazise se konsumit ne intervalin nga zero (barazia ideale) ne nje (pabarazia idelae)		LSMS	LSMS	
10.	Popullsia qe jeton ne familje te papuna Persona nga 0-60 vjec qe jetojne ne familje ku nuk punon asnje anetar i familjes duke perjashtuar kategorite e meposhtme: • Me pak se 18 vjec • 18-24 vjec ne shkolle por nuk jane aktive • 60 vjec e lart dhe nuk punojne		LSMS	LSMS	
11.	Ata qe largohen heret nga shkolla, nuk arsimohen dhe trainohen me Pjesa e popullise nga 18-24-vjec qe ka arritur nivelin 2 ISCED (dmth me arsim 8-vjecar) dhe qe nuk arsimohet apo trajnohet	- Burra - Gra	LSMS	LSMS	
12.	Persona me pak vite arsimimi Pjesa e popullise tek te cilet niveli me larte i arsimimit dhe trainimit eshte ISCED 0, 1 ose 2 (dmth me arsim 8-vjecar)	- Total (burra dhe gra) 25-34 (burra dhe gra) 35-44 (burra dhe gra)	LSMS	LSMS	
13.	Shkalla e aktivitetit Perqindja e te punesuarve dhe te papuneve e popullise totale ne moshe pune 15-64	- Total (burra dhe gra) 15-24 (burra dhe gra) 25-54 (burra dhe gra) 55-59 (burra dhe gra) 60-64 (burra dhe gra)	INSTAT	LFS	
14.	Shkalla e papunesise afat-gjate Totali i popullise ne papunesi afat-gjate (≥12 muaj) si perqindje e totalit te popullise active	- Burra - Gra	INSTAT	LFS	
15.	Pjesë e papunesise afat-gjate Totali i popullise ne papunesi afat-gjate (≥12 muaj) si perqindje	- Burra - Gra	INSTAT	LFS	

	Indikator	Kategorizimi	Burimi aktual	Burimi i ardhshëm	Vlera (Viti)
	e totalit të popullsisë së papunë				
16. Laeken 17	Shkalla e papunësisë me kohe shumë të gjatë Totali i popullsisë së papunë për një kohë shumë të gjatë (≥24 muaj) si përqindje e totalit të popullsisë aktive	- Burra - Gra	Aktualisht i padisponueshëm	LFS	—
17. Laeken 9	Jetë gjatësia e shëndetshme Numri i viteve që një person i shëndetshëm pritet të jetojë - ne moshën 0 - ne moshën 45 - ne moshën 65	- Burra - Gra	MOH	MOH	
18. Laeken 10	Gjendja shëndetësore e vetë-përcaktuar sipas nivelit të konsumit Raporti i përqindjes së grupeve të kuintilëve të poshtme dhe të sipërme (sipas konsumit) të popullsisë 16+ të cilët e klasifikojnë veten me shëndet të dobët apo shumë të dobët	- Burra - Gra	LSMS	LSMS	
19. MDG 1A	Shkalla e varfërisë absolute Përqindja e individëve nën kufirin e varfërisë në nivel kombëtar	- Burra - Gra	LSMS	LSMS	
20. MDG 1B	Shkalla e varfërisë ekstreme absolute Përqindja e individëve nën kufirin e varfërisë ekstreme në nivel kombëtar	- Burra - Gra	LSMS	LSMS	
21. MDG 3A	Përqindja e grave të punësuar me paga në sektorin jo bujqësor		INSTAT LSMS	LFS	
22. MDG 3B	Përqindja e vendeve që zënë grate në parlament		Parlamenti	Parlamenti	
23. MDG 5	Shkalla e vdekshmërisë foshnjore		INSTAT dhe MSH	INSTAT dhe MSH	
24. MDG 7A	Përqindja e popullsisë që ka akses në furnizimin me ujë të rijedhshëm - brenda shtëpise - jashtë shtëpise	Urbane dhe rurale	LSMS	LSMS	
25. MDG 7B	Përqindja e popullsisë që ka akses në WC me kanalizime - brenda shtëpise - jashtë shtëpise	Urbane dhe rurale	LSMS	LSMS	
26. Te tjera	Numri i rasteve të raportuara të dhunës në familje		MB	MB	

	Indikator	Kategorizimi	Burimi aktual	Burimi i ardhshëm	Vlera (Viti)
27.	Te tjera	Numri i rasteve që marrin asistencë të gjore nga shteti	I padisponueshëm aktualisht	I pa zhvilluar	—
28.	Te tjera	Percindja e familjeve me linja telefonie fikse	MPPTT	MPPTT	
29.	Te tjera	Percindja e familjeve me linja telefonie celulare	MPPTT	MPPTT	
30.	Te tjera	Percindja e individëve që kanë shkuar në një ambulancë (gjatë 4 javëve para studimit) për të marrë ndihmë mjekësore	LSMS	LSMS	
31.	Te tjera	Hapësira e banimit për person	LSMS	LSMS	
32.	Te tjera	Shkalla e regjistrimeve neto në arsimin fillor për fëmijet Rome	Aktualisht I padisponueshëm	Studim I ri	—
33.	Te tjera	Shkalla e imunizimit nga fruthi për fëmijet Rome nga moshë 0-1	Aktualisht I padisponueshëm	Studim I ri	—
34.	Te tjera	Pagesa për personat me aftësi të kufizuara në raport me linjen e varfërisë	MPCSSHB LSMS	MPCSSHB LSMS	
35.	Te tjera	Pensionet si përqindje e kufirit kombëtar të varfërisë	MPCSSHB LSMS	MPCSSHB LSMS	

Percaktime

- **Statusi i aktivitetit:** statusi qe individet deklarojne te kene patur per me shume se gjysmen e numrit te muajve te vitit kalendarik
- **Femije ne varesi:** Individe te moshes 0-15 vjec dhe 16-24 vjec nese nuk jane aktive dhe jetojne te pakten me njerin prind
- **Mediani i konsumit ekuivalent:** konsumi total i familjes pjestuar me *madhesine ekuivalente*, ku perfshihet edhe madhesia dhe perberja e familjes, atribuar cdo pjesetari te familjes.
- **Madhesia Ekuivalente:** per te paqyruar diferencat ne madhesine e familjes dhe perberjen familjare, te dhenat e konsumit familjar pjesohen me ekuivalentin e te rriturve nepermjet te ashtuquajtures shkalle ekuivalence e cila i atribuon nje peshe prej 1 te rriturit te pare, 0.5 cdo anetari tjeter te familjes nga mosha 14 vjec e lart, dhe 0.3 secilit femi nen moshen 14 vjec; per shembull, madhesia ekuivalente e nje familje qe perbehet nga 2 te rritur dhe 2 femije nen moshen 14 vjec eshte: $1 + 0.5 + (2 \times 0.3) = 2.1$
- **Median:** pika e mesit e nje perqendrimi, me gjysmen e popullsise me pak ose te barabarte me medianin dhe gjysma tjeter me e madhe ose e barabarte me medianin

Shtojca 1: Strukturat Institucionale shteterore

Fusha e Përfshirjes Sociale	Strategjia	Formulimi i Politikave	Financimi	Ofruesi i shërbimit	Vlerësimi i Politikave	Monitorimi
Rritja e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës	Punesimi	MPCSSHB		Zyrat e punës së MPCSSHB pranë zyrave të pushtetit lokal	MPCSSHB – Struktura e Vlerësimit të Politikave	Inspektoriat i Tregut të Punës në MPCSSHB
Formalizimi i tregut të punës	Punesimi	MPCSSHB		Zyrat e punës së MPCSSHB pranë zyrave të Pushtetit lokal	MPCSSHB- Struktura e Vlerësimit të Politikave	Inspektoriat i Punës në MPCSSHB
Kapërcimi i disavantazheve në arsim dhe formim profesional – rritja e regjistrimeve në arsimin e mesëm	Arsimi Baze	MASH	MASH	Decentralizimi i buxhetit për mirëmbajtje MASH	MASH	Qendra Kombëtare e Vlerësimit (NCEA) në MASH; Inspektoriat në MPCSSHB
	Formimi profesional	MPCSSHB	MPCSSHB	MPCSSHB	MPCSSHB	MPCSSHB
Modernizimi i Asistencës Sociale	Mbrojtja Sociale - Ndihmë Ekonomike	MPCSSHB – Drejtoria e Shërbimeve Sociale	MPCSSHB;	Pushteti Lokal – shpërndarja e ndihmës ekonomike dhe pagesës së paafetësisë	MPCSSHB- Struktura e Vlerësimit të Politikave	SHSSH mbikqyrin shpërndarjen e NE nga Pushteti Lokal
	Mbrojtja Sociale – pagesat për të paafetë dhe familjet	MPCSSHB – Drejtoria e Shërbimeve Sociale	MPCSSHB;	Pushteti lokal – shpërndarja e asistencës ekonomike dhe paafetësisë	MPCSSHB- Struktura e Vlerësimit të Politikave	SHSSH për mbikqyrjen e shpërndarjes së pagesës së paafetësisë nga Pushteti Lokal
Permiresimi i aksesit tek shërbimet	Mbrojtja sociale- institucionet e kujdesit social	MPCSSHB	MPCSSHB;	MPCSSHB – në proces decentralizimi tek pushteti lokal	MPCSSHB- Struktura e Vlerësimit të Politikave	SHSSH
	Shëndetsia	MSH	MSH, ISSH	MSH (përfshi Autoritetin Shëndetsor Rregullor)	MSH	MSH
	Strehim	MPPTT- Drejtoria e Strehimit	MPPTT - Drejtoria e Strehimit dhe Pushtetit Lokal	Pushteti Lokal dhe Agjensia Kombëtare e Strehimit	MPPTT- Drejtoria e Strehimit	MPPTT- Drejtoria për Strehimin
